

IKRE

REVISTË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË MESME ISLAME "MEDRESEJA ISA BEU" - SHKUP
ÜSKÜP "İSA BEY MEDRESESİ" İSLAM LİSESİ ÖRENCİLER DERNEĞİNİN DERGİSİ
СПИСАНИЕ НА ЗДРУЖЕНИЕТО НА УЧЕНИЦИТЕ ОД СРЕДНОТО ИСЛАМСКО УЧИЛИШТЕ "ИСА БЕГ МЕДРЕСЕ" - СКОПЈЕ





SHKOLLA E MESME ISLAME "MEDRESEJA ISA BEU" NDËR VITE

4



KUIZI I DITURISË "BAJRAMI 2008"

9



EDHE GOSTIVARI ME MEDRESE

14



KUR'ANI DHE SHKENCA

23

8 AKTIVITETET E SH.M.I. MEDRESEJA "ISA BEU", PARALELJA E FEMRAVE-SHKUP GJATË MUAJIT TË MADHËRISHËM TË RAMAZANIT

9 MANIFESTIM ME RASTIN E FESTËS MADHËSHTORE TË FITËR BAJRAMIT

10 MANIFESTIMI I KURBAN BAJRAMIT DHE I DITËLINDJES SË MUHAMMEDIT A.S NGA NXËNËSET E PARALELES SË VAJZAVE NË TETOVË

• MEDRESANTET E SHKUPIT MANIFESTUAN DITËLINDJEN E MUHAMMEDIT A.S.

11 NË MEDRESE U SHËNUA DITËLINDJA E MUHAMMEDIT S.A.V.S

• MEDRESANTET E GOSTIVARIT PËR HERË TË PARË NË SKENË

12 "MEDRESEJA ISA BEU" ORANIZOI TURNIRE TË FUTBOLLIT

13 NUK MUND TË HESHTIM!

15 PROFETJA E RREJSHME

• LOJËRAT E FATIT

17 DEXHALLI, MYSAFIR I KËTIJ SHEKULLI

18 ALARM, RINIA ËSHTË NË RREZIK!!!

19 ZGJOHUNI!!!

• DROGA DHE PROSTITUCIONI

20 KU ËSHTË LUMTURIA?

• DITURIA-FUQI E MENDJES

21 SI TA SHFRYTËZOJMË KOHËN

24 NDIKIMI I KUR'ANIT NE BOTË

25 MUHAMED EF. ISENI (1948 - 2007)

• NUREDIN EF. AHMEDI (1955 - 2008)

26 VEHA BIZMI, MOLLA E KALBUR, QË RREZIKON T'I KALBË EDHE TË SHËNDOSHAT

33 PSE NAMAZET KANË KËTO KOHË???

• PENDIMI PREJ VEPRAVE TË KËQIJA-TEUBEJA

34 KËNDI POETIK

36 NUK JAM E SHTYPUR!

37 SHKRONJAT TË THËRASIN MOTËR!!!

38 FEMRA PARA DHE PAS ARDHJES SË ISLAMIT

39 DURIMI I NJË NËNE

40 E FOLURA E FOSHJES

• JETIMI ËSHTË I NDERUAR TEK ALL-LLAHU

42 SI TË SILLEMI NDAJ TË AFËRMVE, JETIMËVE, TË VARFËRVE DHE UDHËTARËVE

43 XHAMIA E DY KIBLEVE

45 PA ISLAM S'KE KURRFARË VLERE

46 ÇELËSI I SUKSESIT SIPAS EBU HANIFES

47 PERLA URTËSIE

48 K.F. "RENOVA"

49 A E DINI SE ...

51 BU NASIL GENÇLIK

53 KUR'AN KONUŞAN BIR DÜNYA DÜNYA KONUŞAN BIR KUR'AN

54 İSLAMDA BİRLİK VE BERABERLİK

• EFENDİMİZ

55 ИСЛАМОТ – ВЕРА НА УМЕРЕНОСТА И СРЕДИШНИОТ ПАТ!

56 ИСЛАМ

57 ОСЛОУВАЊЕТО НА АЛЛАХ Ҷ.Ш

58 HUMOR U ISLAMU



FAQE 29



FAQE 30



FAQE 31

REVISTË E SHOQATËS SË
NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË
MESME ISLAME "MEDRESEJA
ISA BEU" - SHKUP

ÜSKÜP "İSA BEY MEDRESESI"
LİSESİ ÖĞRENCİLER
DERNEĞİN DERGİSİ

СПИСАНИЕ НА ЗДРУЖЕНИЕТО
НА УЧЕНИЦИТЕ ОД
СРЕДНОТО ИСЛАМСКО
УЧИЛИЛИШТЕ „ИСА БЕГ
МЕДРЕСЕ„ - СКОПЈЕ

Kryetar i Shoqatës:
Kujtim MIFTARI

Kryeredaktor:
Ensar SINANI

Këshilli redaktues:

Hazir JASHARI

Enes ALILI

Kadir MINIRI

Muzemil OSMANI

Fesal FETAİ

Suhejb ALILI

Erkan ISLAMI

Nurkan ARUÇ

Engin MEMED - Shtip

Kadrije SEJDINI - Tetovë

Esma XHEMI - Tetovë

Xhejlane MUSTAFA - Shkup

Xhineta ADEMI- Gostivar

Redaktor teknik:

Halil Berisha

Sekretar:

Burhan Ramani

Lektor:

Mr. Elez ISMAILI

Engin MUSLI

Përgatitja kompjuterike:

Fesal FETAİ

Boton:

Bashkësia Fetare Islame e R.M.

SHMI "MEDRESEJA ISA

BEU" SHKUP

Adresa:

SHMI

"MEDRESEJA ISA BEU"

F.P: 80 -1060 fsh.

Kondovë - Shkup

tel/ fax:

02 / 2 058 540 ; 2 058 541

FJALA E REDAKSISË

Rreziku kushtëzon paraqitjen e preventivave dhe mekanizmave mbrojtës, që do të parandalojnë pasojat e kobshme. Në fazën e hershme të tranzicionit, në kohën kur nuk njiheshin dhentë e dhitë, kur rreziku vërehej në horizont, fillon jeta e revistës "IKRE", një revistë rinore, e punuar nga vetë të rinjtë, të cilët më mirë se çdo kush tjetër njohin sfidat me të cilat përballlet rinia.

Obligimin për ta krijuar dhe mirëmbajtur këtë mekanizëm mbrojtës do ta merr vullnetarisht mbi supe shtresa më largpamëse e rinisë, ata që shohin me sytë e zemrës dhe jo të ballit, medresantët, që Islami i mbjellë në shpirt, i aftëson që instinktivisht të lokalizojnë çdo mjet shpërthyes, për ta çaktivizuar siç dijnë ata vetë....

Tanimë gjashtëmbëdhjetë vjet, nxënësit e kësaj shkolle, me elan dhe vullnet të pathyeshëm, i janë përkushtuar nxjerrjes në dritë të kësaj reviste që e keni në duar ju lexues të nderuar. Ky numër i "IKRE"-s, sheh dritën, në këtë kohë, kur ndikimi i "kulturës dhe civilizimit" perëndimor, janë duke arritur qëllimin jetik të tyre, shkatërrimin e çdo vlere njerëzore morale-etike, zhveshjen e plotë të elementit fetar nga qenia njeri. Por edhe nuk dorëzohemi aq lehtë, ne me vite i rrimë karshi këtij invazioni, i dalim në mbrojtje njeriut, muslimanit, muslimanes.

Ajo që dikur ishte shtylla e shoqërisë sonë, femra muslimane, sot ka rënë pre e këtij invazioni, sot ajo ka hudhur kulturën, edukatën islame pas shpine dhe imiton verbër "emancipimin" perëndimor. E vetmja gjë, që na mban me shpresë është fakti se ky virus, kjo mortajë, nuk mundi të kaplojë çdo qelizë të trupit dhe ende kemi femra muslimane, meritore të këtij epiteti, të cilat janë bashkuar në radhët tona, për të sakrifikuar për këto vlera njerëzore, që sot janë në shënjestër. Në këtë numër ju mund të lexoni punime të elaboruara nga vet medresantët, vajzat që i dalin në mbrojtje vajzërisë, ngase nuk duan shtazërinë...

Ne si redaksi ngelim të kënaqur se në këtë kohë të krizës morale, medresantët e kanë kuptuar drejt misionin e tyre, të bindur në Zotin Një, ata vazhdimisht luftojnë, për ta ngritur fjalën e tij, prandaj edhe u përkushtuan maksimalisht në punimin e kësaj reviste dhe fatmirësisht ne patëm problem në përzgjedhjen e temave të shumta të dorëzuara në adresën tonë.

IKRE synon të ecë përkrah pjesëtarëve të shoqërisë ku edhe ajo jeton, t'u ofrojë mbështetje, zgjidhje për problemet dhe sfidat që kanë para vetes. Ne medresantët jemi garda juaj që nuk ndjen aspak lodhje në këtë luftë permanente, por për të realizur këtë ideal asaj i duheni edhe ju, kësaj ushtrie i duhen vullnetarë, të gatshëm për të mbrojtur veten dhe të veten...

Kryeredaktori...



SHKOLLA E MESME ISLAME

"MEDRESEJA ISA BEU" NDËR VITE

Prof. Ibrahim IDRIZI
Drejtor i Medresesë



Shkolla e Mesme Islame "Medreseja Isa Beu" është shkollë e orientuar profesionale dhe bën pjesë në rangun e shkollave të mesme. Ajo është e locuar në fshatin Kondovë, komuna e Sarajit në pjesën perëndimore të Shkupit.

"Medreseja Isa Beu" vazhdon traditën e medresesë se dikurshme me të njëjtin emër, e themeluar në shekullin XV,

me ardhjen e Osmanlinjve në këto troje. Ajo mban emrin e

themeluesit të saj Isa Beut, i cili ka qenë i biri i Is'hak Beut, serhat muhafizit ose mbrojtësit të njohur të Shkupit. Kjo Medrese, në të kaluarën ka prezentuar institucionin më të lartë arsimor në këtë vend dhe njihej si shkollë më me famë në Rumeli. Nga Vakëfnameja e Isa Beut kuptojmë se ai përveç Medresesë ka themeluar bibliotekën dhe xhaminë që mbajnë edhe sot e kësaj dite emrin e tij. Xhamia e Isa Beut është ndërtuar në vitin 1475 dhe është njëra nga xhamitë më të bukura të Shkupit.

Medreseja që nga themelimi e deri më sot ka pushuar së punuari disa herë, për shkak se objekti i Medresesë është shkatërruar nga luftërat dhe fatkeqësitë e tjera. Për herë të parë ka pushuar më 1689, kur gjenerali austriak, Pikolomini me ushtrinë e tij, e dogji Shkupin. Gërmadhat e mureve të godinës së saj, pas këtij shkatërrimi, u ruajtën deri në

fillim të Luftës së Dytë Botërore.

Me tërheqjen e Osmanlinjve nga trojet tona, Medreseja e Isa Beut, me iniciativën e prijësve fetarë dhe intelektualëve të atëhershëm, më 1932

u rindërtua, kështu që në vitin 1936 u krijuan kushte për të filluar me punë të rregullt. Njëkohësisht u reformua edhe programi i saj dhe ajo fitoi statusin e shkollës së mesme. Pas Luftës së Dytë Botërore, ajo sërish pushoi një kohë të gjatë, deri në vitin 1979, kur Bashkësia Islame solli vendimin për rindërtimin e saj. Pas shumë peripecish objekti i ri u ndërtua në fshatin Kondovë dhe me 15 tetor të vitit shkollor 1984/85 filloi procesi edukativo-arsimor. Është e vetmja shkollë e këtij



lloji në Republikën e Maqedonisë si dhe më gjërë në Ballkan.

Medreseja me ndërtesat përreth përfshinë sipërfaqe prej 7000m². Kompleksi i Medresesë përbëhet prej godinës shkollore, konviktit dhe kuzhinës me restorantin.

Në godinën e shkollës qendrore genden tetë mësojtore, dy kabinete të gjuhëve, kabineti i lëndës së informatikës, mesxhidi, biblioteka dhe zyrat e administrates, kurse konvikti ka 53 dhoma me kapacitet për 270 nxënës. Në vitin shkollor 2008/09 numri I përgjithshëm I nxënësve që shkollohen në Medresenë Isa Beu është 518 nxënës. Kështu që, në shkollën qendrore 189 nxënës, në paralelën e vajzave në Shkup 86 nxënës, në paralelën e vajzave në Tetovë 152 dhe atë të vajzave në Gostivar 20, ndërsa në paralelën e djemëve në Shtip 81 nxënës. Numri i nxënësve që dëshirojnë të shkollohen në Medresenë Isa Beu prej vitit në vit është në rritje e sipër, në veçanti asaj të femrave. Gjithashtu edhe një numër i konsiderueshëm i të interesuarve vijojnë mësimet me korendosje, sidomos ajo e gjinisë femrore numri i të cilave arrinë mbi 200 nxënës të çrregull.

Gjatë shkollimit katërvjeçar nxënësit dëgjojnë 29 lëndë, nga të cilat si gjuhë amtare mësohen shqipja, maqedonishtja dhe turqishtja; ndërsa arabishtja si gjuhë profesionale dhe anglishtja si gjuhë e huaj.

Që nga fillimi, në Medrese punojnë mësimdhënës me përgatitje përkatëse profesionale.



Lëndët fetare të cilat nuk kishin fond të plotë i ligjeronin të punësuarit në BI. Ndërsa sot për ngritjen ideore dhe përgatitjen profesionale të nxënësve plan-programin mësimor në të gjitha paralelet, duke përfshirë ato rajonale në Tetovë, Shkup, Shtip dhe Gostivar e realizojnë 29 profesorë në marrëdhënie të rregullt pune dhe 54 me kontratë në vepër dhe honorar. Ka edhe një numër të konsiderueshëm të personelit teknik të cilët përkujdesen për mirëmbajtjen e godines së shkollës, konviktit, kuzhinës etj. Numri i të cilëve sillet afro 30 të punësuar.

Shkollimi në Medrese është gratis. Të gjitha harxhimet i bartë Bashkësia Fetare Islame e RM dhe për 1 (një) nxënës në vit harxhimet llogariten afro 3200 EURO.

Në medrese prej fillimit të punës të procesit edukativ-arsimor 1984 e deri në vitin shkollor 2008/09 janë regjistruar gjithësejt 3232 nxënës të rregullt dhe me korespondencë, ndërsa kanë diplomuar 1209 nxënës. Ghithashtu vlen të theksohet se nga numri i përgjithshëm i të diplomuarve një numër i konsiderueshëm është i gjinisë femrore numri i

të cilave arrinë mbi 300 nxënës.

Edhe përkundër ndërprerjes së punës gjatë historisë së saj Medreseja "Isa Beu" ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e nivelit edukativo-arsimor e fetar të muslimanëve në këto troje, duke dhënë kontribut të çmueshëm për përgatitjen e kadrove të ndryshme të cilët profesionalisht angazhohen në prezantimin dhe kultivimin e këtyre vlerave.

Duke u mbështetur në parimet e traditës islame për pastërtinë dhe rruajtjen e ambientit mund të themi se pastërtia dhe ambienti i brendshëm dhe i jashtëm i Medresesë është në nivel të lakmueshëm. Këtë më së miri e dëshmon pamja e hapsinave brenda dhe jashtë Medresesë, që njëherit paraqet objektin me pamje më të bukur të shkollave në vend.

Klasat e mësimi janë të pajisura sipas nevojës. Në një paralele brenda vitit numri i nxënësve sillet prej 20-30 nxënës. Kjo mundëson që profesori i lëndës brenda orës së mësimi të komunikojë me të gjithë nxënësit. Klasa, në kuptimin teknik, plotëson normat pedagogjike. Gjatë shkollimit, brenda katër viteve sa zgjatë

shkollimi, nxënësi i përvetëson 29 lëmi fetaro- shkencore dhe të kulturës së përgjithshme. Ndërkaq, në fund jep provimin e pjekurisë në lëndët fetare. Nxënësi, pas kryerjes së medresesë, pajiset me diplomë përkatëse dhe kualifikohet për kryerjen e detyrës së imamit, vaizit, hatibit dhe mualimit.

Për ti mësuar sa më mirë gjuhët Medreseja disponon me dy kabinete të gjuhëve, të cilët kanë qenë të pajisura me teknikë dhe aparaturë më bashkëkohore, që nxënësve u ka mundësuar përvetësimin e shpejt të gjuhëve të huaja dhe gjithashtu janë shfrytëzuar edhe për drejtlëximin e Kur'ani Kerimit. Mirëpo me kalimin e kohës dhe si pasojë e zhvillimit të hovshëm teknik-teknologjik, këto kabinete mbetën të papërdorshëm dhe nuk mund të kryejnë funksionin që e imponon koha e sodit. Prandaj, për ti mësuar sa më mire gjuhët dhe të drejtlëximit të Kur'anit Kerimit në kohën e sotme përdoret teknika e kompjutorëve.

Sipas rregullores dhe rendit shtëpiak të medresesë, nxënësit nën udhëheqjen e edukatorëve, falin pesë kohët e namazit në mesxhidin e medresesë me xhematë. Imami dhe hatibi kryesisht caktohen nga nxënësit e viteve të treta dhe të katërta, kurse muezini nga rradhët e nxënësve të vitit të dytë ose të parë. Kjo mundëson që nxënësi dituritë e tij teorike t'i zbatojë në praktikë. Gjatë muajit të Ramazani Sherifit, sipas kërkesave të xhemateve, dërgohen në praktikën e Ramazanit e cila është obligim për të gjithë nxënësit.

Krahas teksteve mësimore të lëndëve përkatëse të përpiluara në baze të plan-programeve të aprovuara nga Riasei i BI në R.M, nxënësit posedojnë edhe



bibliotekën ku pajisen me literature përkatëse. Fondi i librave në bibliotekë është rreth 4.000 tituj me mbi 8.000 ekzemplarë, edhe atë të shkruara në gjuhën shqipe, turqishte, maqedonishte, boshnjakishte, arabishte, anglishte, frengjishte etj.

Godina e konviktit të medresesë ka 53 dhoma të fjetjes me 270 shtretër. Secili nxënës ka dollapin e vet për tesha personale. Nxënësi në dhomën e fjetjes ka të drejtë të pushojë prej orës 21,30 deri në kohën e namazit të sabahut. Nxënësit zgjohen nëpërmjet audio sistemit të shkollës me leximin e ajeteve nga Kur`ani Kerimi. Pas mësimit nxënësi ka të drejtë të pushojë prej orës 14,00 deri 16,00. Pas kësaj kohe në klasat e mësimit bëhet përgatitja për mësimin e ditës së nesërme. Sipas rendit shtëpiak, natën e xhuma në mbikqyrjen e edukatorëve nxënësit pastrohen dhe i ndërrojnë çarshafët e shtretërve.

Në çdo kat të konviktit gjenden dhomat e aktiviteteve të lira. Në rast se nxënësi dëshiron të vazhdojë me lexim edhe pas orës 22 30, atëherë kalon në këtë dhomë ku mund të mësojë ose të lexojë literaturë sipas dëshirës e cila do ti ndihmojë për përsosjen e tij profesionale.

Në rast sëmurje nxënësi vendoset në ambulancën e Medresesë. Sipas nevojës nxënësit i kontrollon mjeku dhe u jep udhëzime përkatëse. Mjeku i shkollës për çdo nxënës ka evidencën përkatëse ashtu që mungesat nga orët e mësimit i arsyeton vetëm ai. Sipas nevojës nxënësi tërhiqet nga dhoma e fjetjes dhe vendoset në dhomën e stacionimit, në katin e parë të internatit .

Medreseja ka edhe kuzhinën e cila u është e detikuar nxënësve që janë të vendosur në konvikt. Përgatitja e ushqimeve

bëhet sipas udhëzimeve të kompetentëve të cilët përcaktojnë kaloritë e ushqimit sipas nevojës së nxënësve edhe atë duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikik të nxënësit. Pastërtia e punës në kuzhinë është në nivel të duhur konform standardeve që kërkohen.

Restorani i shkollës ka kapacitet për 150 nxënës dhe kjo mundëson që të mbahet pastërtia si dhetë ketë rend gjatë ndarjes së. Restorani punon në sistemin e vetëshërbimit por në mbyqirjen e edukatorëve të cilët nxënësin e udhëzojnë që të ushqehet në bazë të parimeve Islame. Në fund të çdo ushqimi nxënësit bëjnë duanë e bukës dhe luten për besimtarët të cilët e furnizojn medresenë me ushqim. Që buka të jetë më cilësore Medreseja ka furnën e vet.

Depoja e medresesë është plotë me artikuj ushqimorë. Këtë e mundësojnë vetë kontributet e besimtarëve të Republikës së Maqedonisë . Përmes vetëkontributit të besimtarëve, medreseja që nga themelimi e gjer më sot nuk ka patur ndonjë pengesë rreth furnizimit me ushqim. Bile nga aktivitetet që zhvillon Bashkësia Islame me besimtarët përmes pagesës së kurbanëve sigurohet

mishi për nevojat e Medresesë.

Medreseja krahas shkollimit të rregullt organizon edhe provime me korespondencë. Rëndësi të veçantë kanë pasur provimet me korespondencë për femra. Mirëpo, me hapjen e paraleleve të vajzave me mësim të rregullt plotësohet edhe ëndrra e kahmotshme e Bashkësisë islame që edhe femra si pjesë e pandashme e shoqërisë Islame, ta inkuadrojë në sistemin e rregullt të shkollimit në R. e Maqedonisë dhe numri i të cilave në këtë vit shkollor 2008/09 arrinë në 258 nxënëse. Dhe krahas kësaj, një pjesë e konsiderueshme e gjinisë femrore regjistrohen si të çrregullta. Prej fillimit të punës së Medresesë e deri në vitin 2004/05 si nxënës me korespondencë kanë diplomuar 270 vajza. Shkollimi i këtillë ka mundësuar që edhe muslimanëja e Maqedonisë të vazhdojë shkollimin e mëtutjeshëm të lartë në qendrat e ndryshme si në Kajro, Aman, Turqi , në Fakultetin e Shkencave islame në Shkup dhe në qendrat, tjera universitare në vend.

Shkolla e Mesme Islame "Medreseja ISA BEU" në Shkup ka statusin e shkollës së mesme. Është e vetmja shkollë e këtij lloji në Republikën e





Maqedonisë. Në medrese shkollon nxënës nga të gjithë pjesëtarët e besimit Islam. Duke filluar që nga viti shkollor 1991/92 në medrese janë shkolluar nxënës nga Shqipëria Bullgaria, Kosova, Sanxhaku ,lugina e Preshevës etj. Andaj lirisht mund të themi se Medreseja ka marrë karakterin e medresesë ballkanike.

PARALELJA RAJONALE E MEDRESESË ISA BEU PËR VAJZA NË TETOVË

Edukimi i femrës zë një vend të rëndësishëm në Medresenë Isa beu dhe që në fillim, si që përmendëm, kemi pasur integrimin dhe përfshirjen e saj në radhët e Medresesë si nxënës me korespondencë. Mirëpo me kalimin e kohës dhe me krijimin e kushteve Bashkësia Islame në R.M. e realizon në praktikë këtë ëndërr të kahmotshme dhe në vitin shkollor 2004/05 hapet paralelja e vajzave me mësim të rregullt në Tetovë. Ndërsa në vitin shkollor 2007/08 diplomon edhe gjenerata e parë në këtë paralele. Sot numri I përgjithshëm I vajzave që shkollohen me mësim të rregullt në këtë paralele arrinë në 152 nxënës.

Në vitin shkollor 2007/08 Bashkësia Fetare Islame e vuri edhe gurëthemelin e parë për ndërtimin e objektit të ri për këtë paralele pasi që objekti I mëparshëm nuk plotësonte kushtet për zhvillimin e procesit të mirëfillt edukativ arsimor.

PARALELJA RAJONALE E MEDRESESË ISA BEU PËR VAJZA NË SHKUP

Me vendim të Bashkësisë F.Islame ,në vitin shkollor 2006/07 hapet paralelja e vajzave me mësim të rregullt në Shkup. Në mungesë të hapsirës

të objektit ,edhe pse interesimi për tu regjistruar në këtë paralele ishte madh, në këtë paralele për çdo vit shkollor është pranuar nga një klasë dhe numri i përgjithshëm në të tre vitet arrinë në 86 nxënës. Në të ardhmen ,mendojm se Bashkësia F.Islame edhe për këtë paralele, sikurse të asaj të Tetovës, do të vënë gurthemel për hapjen e një objekti të ri dhe në këtë mënyrë do të mund të plotësohen të gjitha kërkesat e të interesuarëve për t,u regjistruar në këtë vatër arsimore në një njërën anë, dhe në anën tjetër do të plotësohen të gjitha kushtet për mirëvajtje më të sukseshme në zhvillimin e procesit edukativ arsimor.

PARALELJA RAJONALE E MEDRESESË ISA BEU PËR VAJZA NË GOSTIVAR

Duke pasur parasysh se vetëm një femër e edukuar në frymën Islame do të jetë e gatshme t'u përgjigjet sfidave të kohës, Bashkësia F.Islame në vitin shkollor 2008/09 hap edhe paralelen e tretë me radhë të vajzave në Gostivar. Për fillim pranohet vetëm një klasë me 20 nxënës.

PARALELJA RAJONALE E MEDRESESË ISA BEU PËR MESHKUJ NË SHTIP

Duke pasur parasysh ngritjen e vlerave fetare islame të muslimanëve të Maqedonisë Lindore si edhe mungesën defecitare kadrovike të kësaj ane Bashkësia F.Islame R.M. vendos që edhe në këtë rajon të hap paralele për meshkuj të Medresesë Isa Beu. Kështu që në vitin shkollor 2005/06 fillon me mësim të rregullt kjo paralele. Sot numri përgjithshëm I nxënësve që shkollohen në këtë paralele arrinë në 81 nxënës. Mësimi për

dallim të paraleleve tjera të Medresesë zhvillohet në gjuhën Turqishte dhe atë Maqedone. Kjo paralele është e tipit me konvikt.

Për ta përfunduar këtë atikull për Medresenë është me rëndësi të ptencojm se Bahkësia Fetare islame në R.M.kohëve të fundit është duke bërë investimin më të madh në të gjitha aspektet në drejtim të krijimit të kushteve sa më të mira të ngritjes së vlerave edukative arsimore tek gjeneratat e reja. Në veçanti, dëshirojmë të theksojmë hapin e madh që e ka ndërmarrë me inkuadrimin e femrës muslimane në procesin e rregullt edukativ arsimor respektivisht, me hapjen e paraleleve të Medresesë Isa Beu për vajza në Shkup, Tetovë dhe Gostivar. Ky, pra, është një hap I madh Bashkësisë F.Islame në zgjerimin e rrëjetit të shkollimit të femrës sepse krahas mashkullit, ajo me edukate Islame dhe me mësim-besimin fetar do ta edukoj edhe femrën si një bashkëudhëtare e rëndësishme e njerëzimit në jetë. Duke pasur parasysh rolin e saj në familje ku apriori fillon të zbatohet edukata për brezin e ri, këto paralele, mendojmë se do të japin një kontribut tejet të rëndësishëm në këtë drejtim.

Në fund, këto të dhëna për Medresenë, maturantëve të kësaj shkolle t'u shërbej si përkujtim për vitet e kaluara në këtë vatër shkollore dhe jemi të mendimit se Medreseja që nga fillimi i themelimit të saj e deri në ditën e sotme i ka plotësuar qëllimet veta programore në fushën e procesit edukativ arsimor dhe frymës së vlerave të pastërta Islame. Ndaj, kësaj gjenerate i dëshirojm sukses të mëtutjeshme në ndërtimin dhe ngritjen vlerave të një personaliteti të punëtorit të vyejshëm Islam.



AKTIVITETET E SH.M.I. MEDRESEJA "ISA BEU", PARALELJA E FEMRAVE-SHKUP GJATË MUAJIT TË MADHËRISHËM TË RAMAZANIT

Paralelja e femrave të Medresesë "Isa Beu"- Shkup, për hirë të muajit të madhërishtëm të Ramazanit hartuan një projekt për aktivitete gjatë muajit të bekuar.

Projektin ia prezentuan institucionit më të lartë fetar Bashkësisë Fetare Islame, drejtorisë së Medresesë "Isa-Beu" dhe Myftinisë së Shkupit. Në këtë projekt kishin prezentuar planin realizues të paraleles lidhur me vizitat e xhamive nëpër qytetet e Maqedonisë dhe organizimin e programeve të ndryshme për hir të Ditës së Bedrit, Natës së Kadrit si dhe manifestimin me rastin e festës madhështore islame Fitër Bajramin.

Gjatë tërë muajit nëpunëset e kësaj paraleleje së bashku me korin e femrave vizituan një numër të madh të xhamive në qytetin e Shkupit dhe më gjërë, ku nëpër këto tubime u përcollën mesazhet fetare lidhur me madhësinë e këtij muaji të bekuar, me theks të veçantë është prezentuar roli i femrës në familje dhe nevoja e saj në institucionet shtetërore.

Nëpër këto tubime janë prezentuar edhe projektet e BFI lidhur me femrën muslimane si nënë dhe edukatore e gjeneratave të ardhshme, ngase Feja Islame më së tepërmi ka kontribuar për lirinë e gruas nga prangat e robërisë duke e ngritur në pozitën e saj të cilën edhe Zoti ia ka dhënë.

Gruas të drejta më së shumti i ka dhënë Islami ku kjo dësh-



mohet në Kur'anin Famëlartë dhe traditën e Muhammedit a.s.

BFI është e vetëdijshme për rolin dhe pozitën që duhet ta luajë dhe ta ketë femra në shoqërinë tonë andaj, dizajnon projekte kolosale lidhur me femrën muslimane, një ndër projektet është hapja e paraleleve të femrave të medresesë "Isa-Beu" në Shkup, Tetovë dhe Gostivar, me këtë hapi rrugët që u takojnë për fushëveprim shoqëror.

Pozita e femrës muslimane është e prezentuar në librin e qartë Kur'anin Famëlartë, andaj edhe shoqëria duhet që asaj t'i japë pozitën që i takon por e ndërtuar në bazë të principeve islame. Gjatë këtyre vizitave janë mbajtur ligjerata nga profesoret e kësaj paraleleje, tubimet e njejta janë begatuar edhe me programet e realizuara nga kori i femrave.

Më 15.09.2008 meqë ishte ditë e veçantë e këtij muaji është dita e madhe e Bedrit e cila ka një pozitë të veçantë në kalendarin dhe historinë islame,



nëpunëset dhe kori i femrave realizuan një program fetar. Programi në fjalë u realizua në xhaminë e Isa Beut, në të cilin program fetar përveç që është ligjeruar në te janë prezentuar urtësitë, filozofia dhe mesazhet që burojnë nga kjo ditë madhështore për botën islame.

Ky program mori një pamje të veçantë pasi që edhe u begatua me këndime fetare si pjesë nga Kur'ani, ilahi si dhe mevlud.

Po në të njëjtën xhami më datë 26.09.2008 me rastin e natës madhështore të Kadrit u realizua edhe një program fetar ku edhe njëherë u dhanë mundësi femrave muslimane që të prezentojnë në program fetar me rastin e kësaj nate të bekuar.

KUIZI I DITURISË “BAJRAMI 2008”



Islami asnjëherë nuk proklamoi festa, të cilat nuk kanë domethënie apo thjeshtë janë vetëm formale, por çdo herë përmes festave pretendon pastrimin dhe edukimin shpirtëror. Kurbanit është simbol i devotshmërisë, nënshtrimit dhe dorëzimit ndaj All-llahut xh.sh. Kjo ngase me therjen e kurbanit, te All-llahu nuk arrin gjaku dhe mishi, por nijeti-qëllimi dhe motivi i njeriut në therjen e kurbanit. Kurbanit në vete ngërthen karakterin mirënjohës dhe falënderues ndaj All-llahut xh.sh. Përmes therjes së kurbanit, njeriu i tregohet mirënjohës All-llahut dhe e falënderon Atë për të mirat dhe begatitë që ia fali. Dhe një festë kaq me rëndësi nuk mbeti pa u festuar edhe nga nxënësit e Medresesë “Isa Beu”- Shkup, që përmes Shoqatës së tyre, organizuan një program enkas për këtë festë.

Më datën 5 dhjetor të vitit që lamë pas, Shoqata e Nxënësve me iniciativë të klasës së III-a, organizoi kuizin e diturisë “Bajrami 2008”. Si gjithmonë kuizi filloi me leximin e një pjese të Kur’anit nga njëri prej hafizëve të shkollës, i cili na kënaqi zemrat me zërin e tij të bukur. Më pas vijoi prezantimi i kuizit nga udhëheqësi programit Ensar Sinani, i cili pas kësaj ftoi në skenë drejtorin e shkollës prof. Ibrahim Idrizi i cili njëherit i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi nxënësit për aktivitetin e bërë për këtë festë madhështore.

Ky kuiz ishte i karakterit të përgjithshëm, ku ishin të përfshirë pyetje nga lëmi të ndryshme edhe atë nga spektri fetar, shkencor dhe sportiv. Vlerësimin profesional e bëri juria e përbërë prej: Mr. Elez Ismaili, prof. Gajur Beluli dhe prof. Muharem Loki. Në kuiz garonin 16 garues, edhe atë nga 2 nxënës prej çdo klase. Garuesit u ndanë në 4 grupe, ndarja u bë me hedhjen e shortit, ashtu që në çdo grup kishte nga një nxënës prej secilit vit. Kuizi kishte tri rubrika: Rubrikën: PO-JO. Rubrikën: Pyetje –Përgjigje dhe rubrikën:A-B-C.

Në pauzën mes të rubrikave pati edhe disa pjesë humori të përgatitura nga humoristët tanë të talentuar Arsim Idrizi dhe Minir Veseli, ndërsa nxënësi Muzemil Osmani recitoi poezinë e titulluar “Ende s’është vonë”. Këtë manifestim e bëri më madhështor edhe paraqitja e korit me disa ilahi të zgjedhura ekskluzivisht për këtë manifestim. Fitues i kuizit të sivjetmë doli grupi B, në përbërje të Fesal Fetai, kryesues i grupit, si dhe Mumin Veseli, Muhamed Ramadani dhe Alban Alija.

Në fund u ndanë dhurata për të gjithë garuesit, në shenjë mirënjohje dhe si shpërblim për pjesëmarrje. Me organizimin e këtij kuizi, nxënësit dëshmuar se kanë çuar në vend urdhërat kur’anore dhe hadithet e Muhamedit a.s. që kanë të bëjnë me diturinë.

Raporton: Muzemil Osmani III-A Shkolla Qendrore

MANIFESTIM ME RASTIN E FESTËS MADHËSHTORE TË FITËR BAJRAMIT

Më 02.10.2008 Medreseja “Isa-Beu” paralelja e femrave-Shkup me rastin e festës së madhe fetare të botës islame Fitër Bajramit organizoi manifestim fetar. Ky programin festiv “Me fat festa e Fitër Bajramit” që u realizua në Teatrin Shqiptar në Shkup, tuboi një numër të madh të besimtareve për të ndjekur për së afërmi këtë manifestim.

Fillimisht të pranishmit i përshëndeti prezentuesja dhe udhëheqësja e manifestimit z-sha Resmije Xhaferi e cila përcolli mesazhin e Reis -ul Ulemasë së Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi. Mesazhi i tij ngërthen vlerën dhe rëndësinë e madhe të kësaj feste. Njëherit i uroi të gjithë besimtarët muslimanë.

Prezentuesja e këtij manifestimi shpalsi projektin e realizuar nga Medreseja Isa-Beu të paraleles së femrave-Shkup gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit dhe si përmblyje e këtij projekti është realizimi i manifestimit me shënimin e festës së madhe mbarëshoqërore islame Fitër Bajrami. Ky manifestim u begatua me korin e nxënësve të Medreses “Isa-Beu” paraleles së femrave nga Shkupi si dhe orkestrin e BFI -së udhëhequr nga Mr. Abaz Jahja



MANIFESTIMI I KURBAN BAJRAMIT DHE I DITËLINDJES SË MUHAMMEDIT A.S NGA NXËNËSET E PARALELES SË VAJZAVE NË TETOVË

Me datë 09.12.2009 në Pallatin e Kulturës në Tetovë, nxënëset e Medresesë së Isa Beut -paralelja e vajzave në Tetovë, me rastin e manifestimit të Kurban Bajramit,u prezantuan para publikut me programin “E GËZOFSHI BAJRAMIN”. U prezantuan me një program të bujshëm i cili përmbante: recitime me përmbajtje të problemeve të kohës, ilahi, kaside dhe ashere nga Kur’ani famëlartë.

Për këtë shfaqje u angazhuan: prof. Bahri Aliu, i cili në mënyrë të veçantë u angazhua, që shfaqja të ketë përmbajtje dhe koncept të shëndoshë, stafi pedagogjik i medresesë, sidomos prof. Fatime Beshiri, prof. Jonuz Sulejmani, prof. Nexhadi Limani, i cili i ushtroi asheret, gjithashtu edhe udhëheqësi i Korit të vajzave prof. Abas Jahja, i cili vazhdimisht ka ushtruar korin e paraleles së vajzave në Tetovë.

Me rastin e ditëlindjes së vulës së pejgamberisë, Muhammedit a.s me datë 08.03.2009 në Pallatin e Kulturës në Tetovë nxënëset e Paraleles së Medresesë në Tetovë prezantuan programin tradicional “MIRË SE ERDHE HANË E URUAR”. Shfaqën një program modest - festiv, me të cilin përkujtuan të madhin Muhammed a.s.

Pjesa e parë e programit u hap me leximin e një ashereje nga Kur’ani, pastaj u lexuan pjesë nga mevludi i Hafiz Ali Ulqinakut, pjesë nga mevludi i Tahir Popovës dhe pjesë nga mevludi i Fahrudin Osmanit. Pjesa e parë gjithashtu përmbante edhe recitale dhe poezi. Kurse pjesa e dytë përmbante ilahi të zgjedhura enkas për lindjen e Muhammedit a.s.

**Raporton:Kadrije Sejдини IV-B
Paralelja e Femrave - Tetovë**



MEDRESANTET E SHKUPIT MANIFESTUAN DITËLINDJEN E MUHAMMEDIT A.S.

Më 8 mars të vitit 2009, SHMI “Medreseja Isa Beu” Paralelja e Femrave - Shkup kremtoi lindjen e Muhammedit a.s. (Mevludin).

Manifestimi e kësaj dite u bë në xhaminë e Isa Beut në Shkup, duke filluar në ora 13,pas faljes së namazit të drekës. Madhështinë këtij manifestimi ia dhuroi numri i madh i besimtareve myslimane, qw prezantuan në xhami për ta përcjellë këtë program, të organizuar nga nxënëset e Paraleles së Femrave të Shkupit.

Ky program u begatua me ashere, mevlud, ilaçi, ligjëratë deh në fund dua.

Programin e hapi prof. Resmije Xhaferi me përshëndetjet dhe uratat në emër të stafit punues të Medresesë së Vajzave të Shkupit. Pastaj me temë Ardhja e Muhammedit a.s. mëshirë për gjithë njerëzinë, ligjëroi prof. Hyrijete Ganiu. Vend të posaçëm në program patën ilahitë, të cilat u kënduan në gjuhën shqipe, turke, arabe dhe boshnjake, interpretuar nga kori.

Më pas vijoi leximi i disa pjesëve të mevludit dhe disa ashereve nga nxënëset po edhe nga mysafirët e pranishëm. Gjithashtu u recituan fjalë të bukura poetësh e dijetarësh të mëdhenj dhe në fund duanë e bëri prf. Munevere Murtezi në gjuhën arabe dhe prof. Resmije Xhaferi në gjuhën shqipe.

“Medreseja Isa Beu” Paralelja e Femrave - Shkup nxënëseve u dhuroi nga një trëndafil si dhuratë simbolike për hir të ditëlindjes së Muhammedit a.s.



NË MEDRESE U SHËNUA DITËLINDJA E MUHAMMEDIT S.A.V.S

Ashtu si vitet tjera edhe këtë vit shoqata e nxënësve të SHMI “Medreseja Isa Beu”, në lokalet e Medresesë, organizoi manifestim për hir të ditëlindjes së pishtarit që ndriçoi tërë botën, vulës së pejgamberisë, Muhamedit a.s. Manifestimi në fjalë përbante një program të pasur kulturor-artistik, që përfshijte një koktel, ku në masë të duhur ishin përfshirë këndimi ilahive, mevludit si recitimi i vargjeve kushtuar



kësaj figure madhështore. Duke filluar programi me leximin e një pjesë të Kur’anit Famëlartë, nga njëri prej hafizëve të shkollës, iu dha vendi i merituar traditës islame sa i përket mënyrës së fillimit të një pune, me fjalën e Allahut, e cila me muzikalitetin e saj dhe melankolinë e zërit të recituesit bënë të rrëqethen zemrat e të pranishmëve. Më pas vijoi prezantimi i programit nga udhëheqësi i cili pas hapjes

zyrtare të këtij evenimenti ftoi në skenë u.d. drejtor prof. Ibrahim Idrizin, t’i përshëndesë të pranishmit. Pjesa e parë përfundoi me referatin kushtuar historikut të jetës së Pejgamberit a.s.

Ndërsa pjesa e dytë filloi me prezentimin e parë të korit të shkollës, që në këtë manifestim u paraqit me disa ilahije të zgjedhura enkas për këtë ditë, të cilat i kushtoheshin njeriut më me

ndikim në historin njerëzore Muhamedit a.s. Vlen për të theksuar se përgatitja e korit është meritë e Dr. Mensur Nuredinit, ndërsa përgatitjen e recituesve e bëri Mr. Elez Ismail icili ia rriti vlerën këtij programi edhe më shumë.

Ndërsa pjesa e fundit ishte leximi i mevludit në gjuhën shqipe dhe atë turke, për të përkujtuar përmes këtyre vargjeve të melodizuara, fragmente të historisë së të Dërguarit a.s. Programin e mbylli udhëheqësi, i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe potencoi se ky program është shumë modest përballë vlerës dhe meritës të Dërguarit mëshirë për të gjitha kohërat

**Raporton: Muzemil
Osmani
III-A - Qendër**

MEDRESANTET E GOSTIVARIT PËR HERË TË PARË NË SKENË

Gostivari vazhdoi traditën disa vjeçare në manifestimin masovik të ditëlindjes së Muhamedit a.s. të dërguar mëshirë për botët. Edhe sivjet më 12 rebiul - evvel sipas Hixhretit, pra më 8 mars u realizua programi tradicional “Mirë se erdhe o Resulallah” në palestrën e sportit “Rinia” në Gostivar, në organizim të Muftinisë së Gostivarit.

Programin e ndoqi një numër shumë i madh i besim-



tarëve që e mbushën palestrën e madhe dhe duhet thënë edhe pse organizatorët për të rritur

kapacitetin kishin vendosur një numër të madh karigesh në vet fushën e lojës, përpara binës, përsëri boll njerëz qëndruan në këmbë, për ta përcjellë programin e përgatitur. Lirisht mund të themi se numri i të pranishmëve në sallë ishte mbi 4 mijë njerëz.

Programi, si çdo vit i ngjeshur, kulturor – artistik, u hap me një ezan të bukur dhe një ashere nga Kur’ani



Famëllartë dhe si për habi, por fatmirësisht nuk pati fjalë të stërzgjatura të rastit përpos dy – tri fjalëve të shkurtra por me vend, të mysafirit nga Komuniteti Musliman i Shqipërisë, me çka u bë një hap përpara në organizimin e programeve të këtij lloji.

Por ajo që e bëri këtë manifestim të dallojë nga të gjithë të mëparshmit, është paraqitja e parë e korit të Medresesë së sapoformuar të vajzave në Gostivar, që u prit me entuziazëm të madh nga të pranishmit në sallë. Kori i vajzave së bashku me Korin e Muftinisë së Gostivarit, të përgatitur nga Mr. Eljesa Asani u

prezantuan me disa ilahi dhe kaside të përzgjedhura enkas për këtë manifestim. Ilahitë ishin në gjuhën shqipe, turke, boshnjake dhe arabe, duke plotësuar kërshërinë e të gjithë dashamirëve të këtij arti mistik.

Risi tjetër në programin e sivjetshëm është prezenca e artistit të popullit, mysafirit të famshëm nga Shqipëria Mirush Kabashit, i cili u prezantua para publikut gostivaras me një poezi kushtuar Muhammedit a.s., me çka ngriti nivelin dhe vlerën e manifestimit në fjalë.

Si çdo vjet në mes dy pjesëve të programit u shfaq një dokumentar i shkurt për biografinë e Muhammedit

s.a.v.s. Më pas vijoi një recitim në gjuhën turke dhe paraqitja e dytë e Mirush Kabashit me poemën e famshme “Kosovari”, i cili emocionoi të gjithë publikun, të mëdhenj e të vegjël. Emocionet vazhduan të mbajnë nivelin me paraqitjen e dytë të korit të Medresesë dhe atij të Muftinisë së Gostivarit, ndërsa programi u mbyll me ndarjen e mirënjohjeve, personaliteteve që kontribuan në zhvillimin e Islamit në rrethin e Gostivarit dhe me lutjen e moderatorit që tradita e organizimit të këtij manifestimi të mos ndalet kurrë...

**Raporton: Fesal Fetai III-B
Shkolla Qëndrore**

“MEDRESEJA ISA BEU” ORGANIZOI TURNIRE TË FUTBOLLIT

Sporti zë vend të rëndësishëm në jetën e përditshme të medresantëve, e në veçanti futbolla si sport i parapëlqyer në këtë mes. Zakonisht sa fillon ta ngrohet moti, në kohën e lirë alternative e parë është një lojë futbolla në stadiumin e shkollës.

Kjo dashuri që ndjejnë medresantët për këtë sport ka bërë që vite me radhë, në këtë shkollë të organizohet turniri tradicional në futboll. Ndër vite nxënësit e Medresesë kanë marrë pjesë në turne të ndryshme të organizuara nëpër nga Medresetë e viseve ballkanike dhe gjithashtu kanë fituar çmime të shumta. Si vjet nxënësit e shkollës qendrore në Shkup dhe Paralelja e Djemve në Shtip organizuan disa turne futbolla edhe atë:

TURNIRIN TRADICIONAL

Edhe këtë vit si çdo vit tjetër nxënësit e Medresesë organizuan turnirin tradicional në futboll të vogël ku morën pjesë



ekipe përfaqësuese të klasave të shkollës. Në turnir morën pjesë gjithsej 10 ekipe, që garuan mes veti për titullin prestigjioz ekipi më i mirë i vitit në Medrese. Ajo që vlen të përmendet është shpirti garues i medresantëve që bënë të humbet dallimi i moshës dhe në teren që të gjithë u shfaqën kompetitiv dhe treguan një futboll cilësor, duke rritur kështu vlerën dhe kualitetin e këtij turniri. Fitues doli ekipi i klasës III-b, të cilët në lojën finale u përballën me ekipin e klasës III-a. Në fund pas përfundimit të turnirit të

gjithë festuan së bashku në ahengun e përbashkët të përgatitur nga organizatori.

TURNIRIN MIQËSOR NË SHTIP

Paralelja e shtrirë e djemve në Shtip, në fund të prillit organizoi një turnir miqësor në futboll, ku ishin të ftuar shkollat e mesme të qytetit të Shtipit, Radovishit dhe “Medreseja Isa Beu” Shkup, gjegjësisht shkolla qendrore si mysafit special. Një organizim i këtyllë është për t’u përshëndetur marrë parasysh mesazhin që përcjell dhe faktin që kontribuon në formimin e

NUK MUND TË HESHTIM!



një imazhi të drejtë të Islamit në përgjithësi si dhe të Medresesë dhe Paraleles së Shtipit në veçanti, që janë për bashkëjetesë miqësi dhe bashkëpunim me të gjithë pjesëtarët e shoqërisë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare e nacionale.

Turniri u zhvillua sa më mirë që mundej, mysafirët u pritën në mënyrë shembullore, organizatori kishte përgatitur kafjallin dhe drekën për mysafirët dhe gjithashtu një vizitë Medresesë së atjeshme.

Ndeshjet u zhvilluan shumë korrekt, ndërsa fitimtarë doli Shkolla e Mesme Medicinave Turke e qytetit të Radovishit, ndërsa ekipi i Medresesë mori mirënjohje për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë në zhvillimin korrekt të këtij turniri.

Nxënësit që përfaqësuan Medresenë u kthyen me nga një dhuratë shumë të veçantë, koordinatori i Paraleles së Shtipit u dhuroi nga ekzemplar të Kur'anit Famëlartë.

**Raporton: Betim Abduli I-B
Senad Abduli I-A
Shkolla Qendrore**

"Kush prej jush sheh një të keqe, le ta largojë atë me dorën tij, e nëse nuk mundet atëherë me gjuhën e tij..." Hadith

Nuk mund të heshtim përpara kësaj të keqe kaq të madhe dhe mos ta përfillim fjalën e të Dërguarit tonë, i cili na obligon që të këqijat që paraqiten në mesin tonë t'i largojmë me forcë, me dorën tonë, por nëse nuk mundemi atëherë thotë, luftoni ato me gjuhën tuaj me fjalën tuaj, ngrini zërin tuaj ndaj saj dhe mos heshtni, e po heshtët atëherë ta urreni të keqen me zemër, ndonëse kjo është shkalla më e ulët e besimit. Që prej disa ditësh, ligjëruesit e lëndës së mësim-besimit më nuk hyjnë nëpër klasa me ditarë në dorë, nuk mbajnë më orë, nxënësit e klasave të pesta nuk dëgjojnë më ligjërata nga lënda e tyre e preferuar, pasi kohë më parë Gjykata Kushtetuese e R. së M. solli vendim për të abroguar nenin 26 të ligjit për shkollimin fillor, me të cilin lejohej përfshirja e lëndës së mësim-besimit në shkollat fillore dhe tërë këtë e bëri me pretekstin se mbron sekularizmin e shtetit dhe se kushtetuta e Maqedonisë nuk lejon një gjë të tillë. Atëherë kur menduam se ëndrra e kamotshme e jona, për të cilën kemi luftuar që nga pavarësimi i Maqedonisë në vitin 1991, po realizohej dhe të rinjtë tanë do të mësonin fenë e tyre nëpër shkolla, qielli i kthjellët u kaplue nga retë e zeza, të cilat sollën lajmin e zi se Gjykata Kushtetuese ndaloi mësim-besimin. Të gjithë u zhgënjem pa masë dhe të habitur pyetnim veten se si është e mundur të ndodhë kjo dhe në fillim sikur nuk na besohej por kur Ministria u ndaloi ligjëruesve të kësaj lënde hyrjen nëpër shkolla, gjithçka u konkretizua. U bë hera e dytë që mësim-besimi fillon dhe ndalet

sërish dhe filluan të zbehen shpresat se edhe ne në këtë shtet do të gëzojmë lirinë fetare të garantuar me të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare.

Ajo që na irriton edhe më shumë është se kundër këtij vendimi nuk reagojnë të zgjedhurit e popullit, që ruajnë karriget e tyre në kurriz të atyre që u dhanë pushtetin të cilin e gëzojnë. Reagojnë taksistët, bashkësitë fetare, ligjëruesit e lëndës së mësim-besimit, nxënës e studentë, po edhe qeveria, reagojnë edhe ne që shprehim protestën tonë përmes kësaj shkrese, ndërsa partia shqiptare në pozitë le që nuk reagoi, por edhe e kritikoi partnerin e saj qeveritar për reagimin ndaj vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke thënë se në demokraci lejohet vetëm debati ndërpartiak dhe jo debati në raport me institucionet, vendimet e të cilëve sipas tyre qenkan të përvokueshme. Hë si na çuditën! Po sa të marrë që janë, shkelin mbi vullnetin e vet elektoratit të cilit ia kërkuan votën dhe harrojnë se kush i solli në atë pozitë. Shumë shtete në botë dhe Evropë janë laike por kanë të përfshirë lëndën e mësim-besimit, bile edhe të pakicave dhe të emigrantëve, gjë që na bën të dyshojmë seriozisht në vendimin e kësaj gjykate. Vallë si është e mundur që shteteve të tjera të mos u cenohet laicizmi nga mësim-besimi, ndërsa Maqedonisë po?! Përgjigjen nuk e dijmë, por shpresojmë të jetë e vërtetë thënia popullore "e treta, e vërteta" dhe që hera e tretë e përfshirjes së mësim-besimit nëpër shkolla, që shpresojmë të ndodhë së shpejti, të jetë "e treta, e vërteta" dhe kjo lëndë të bëhet pjesë permanente e plan-programin e shkollave fillore.

**Ensar Sinani III-A
Shkolla Qendrore**



EDHE GOSTIVARI ME MEDRESE

26 qershor 2008, ditë historike, ditë madhështore që duhet të ngulitet në kokën e çdo muslimani të Gostivarit dhe rrethinës së tij, ditë nga ku fillon kthesa e madhe, ditë nga e cila do të burojë ringjallja e njeriut si qenie fetare dhe morale. Në këtë ditë edhe dielli leu i buzëqeshur, sikur donte të paralajmërojë se në atë ditë do të merrej një vendim historik, që do të shënonte pikënisjen e ndryshimit të shumëçkahit në shoqërinë tonë, atë ditë të martë në mbledhjen e Riasetit të BFI të RM, u pranua propozimi i Muftinisë së Gostivarit, dhe u soll vendim që edhe në Gostivar, të hapet një paralele për vajza në kuadër të SHMI "Medreseja Isa Beu"- Shkup, e cila tanimë kishte shtrirë degët e saja në Shtip për djem, në Tetovë dhe Shkup me paralele për vajza.

Kjo ditë i mundësoi edhe Gostivarit të formojë gjenerata të shëndosha, i dha obligim të aftësojë ushtarë që në të ardhmen do t'i dalin në mbrojtje atij pak dinjiteti njerëzor, të edukojë në frymën e vërtetë këto vajza e t'i shndërrojë ato në edukatore të ardhme të kësaj shoqërie që është duke u zhveshur nga të gjitha vlerat morale-njerëzore.

Mjafton të thuhet se ky institucion fetar-arsimor, hapja e të cilit i gëzoi të gjithë, do të ketë qëllim dhe obligim të edukojë e arsimojë femrën muslimane dhe nga kjo vetvetiu kuptohet vlera e tij, pasi siç e dimë të gjithë pa përjashtim, femra është shtylla e shoqërisë.

Gjithashtu hapja e kësaj



Medreseje, mundësoi që tërë ai kuadër profesional i Gostivarit të ketë kujt t'ia bartë e t'ia mësojë vlerat e Islamit, thënë shkurt t'u mundësohet të kryejnë punën për të cilën ata janë aftësuar në studimet e tyre, atë që e kanë qëllim jetësor të tyre, t'ua mësojnë Islamit gjeneratave të reja.

Gjithçka filloi të konkretizohet me konkursin për pranimin e nxënësve që do ta ndiqnin mësimin e rregullt në Shkollën e Mesme Islame "Medreseja Isa Beu" Paralelja e e vajzave në Gostivar. U pranuan 21 nxënës që patën fatin të jenë gjenerata e parë, që do të dalë nga kjo shkollë.

Sot në paralelen për vitin e parë janë angazhuar 13 profesorë e profesoresha që ligjërojnë lëndët e parapara me plan-programin e SHMI "Medreseja Isa Beu" - Shkup.

Hapja solemne e Paraleles së Vajzave në Gostivar u bë më 29.09.2008 në prezencë të kryesisë së BFI-së, të udhëhequr nga Kryetari i BFI-së, Reisul Ulema H.Sulejmani ef.Rexhepi, Muftiut të Muftinisë së Gostivar Hfz.

Shaqir ef.Fetahu, Drejtorit të SHMI "Medreseja Isa Beu" prof. Ibrahim Idrizi, delegacioneve nga muftinitë tjera, profesorëve dhe të punësuarve të tjerë të Muftinisë së Gostivarit.

Për momentin procesi edukativ - arsimor përkohësisht, deri në fillimin e ndërtimit të objektit të ri, zhvillohet në katin e dytë të ndërtesës së Muftinisë së Gostivarit, por duhet theksuar se objekti i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen normale të mësimin, zyrën e administratorit të paraleles, zyrën e profesorëve, mesxhidin, bibliotekën, dhomën për aktivitete të lira, kuzhinën, abdes-hanen dhe pushimoren.

Shpresojmë edhe jemi të bindur se me ndihmën e të Madhit Zot, se edhe kjo paralele do të jetë një tempull i shenjtë i kultivimit dhe ngritjes së vetëdijes, në avancimin e vlerave të mirëfillta fetare, si dhe do të luaj rol të rëndësishëm në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të ardhshme.

**Xhineta Ademi &
Zemrije Ademi viti I
Paralelja e Femrave - Gostivar**



PROFETJA E RREJSHME



"Unë jam profetja, e dërguara e Zotit, engjëlli me krahë. Unë zhduka hënën nëntë herë, unë solla pavarësinë e Kosovës". Me këto fjalë një zonjë e vetëshpallur profete, të cilën e pamë të gjithë ditë më parë në "Top Show" pretendonte se shëronte të gjitha sëmundjet vdekjeprurëse. Çdo ditë përpara derës së shtëpisë së saj shikon njerëz që presin me padurim ta takojnë, sepse besojnë se do të shpëtojnë nga halli që i ka zënë. Nëse kjo profete me thëniet e saj nuk do të cenonte askënd, askush nuk do të merrej me të. Por Anila Minxha me "profecinë" e saj, me "dhuntinë" e saj po merr në qafë dynjanë. Njerëzit e sëmurë që kanë humbur shpresën për të jetuar, që kanë pasur fatin e keq të shkojnë në derën e saj, nuk besojnë më në mjekësi dhe në shkencë, por te broçkullat e saj. Njerëzit, kjo profete, pretendon se i shëron me të prekur. Pra u largon çdo sëmundje, qoftë kjo edhe vdekjeprurëse, vetëm me një prekje. Pra, pretendon se shëron edhe tumoret. Por të gjithë të sëmurët që drejtohen në derën e saj duhet të përmbushin një kusht:

Të heqin dorë nga kurat që u kanë dhënë mjekët.(dhe për ketë paguajnë një kosto të lartë parash, po askush nuk po flet për paratë kur vjen në pyetje shendeti.) Megjithatë, njerëzit në hall e besojnë verbërisht këtë grua. Shtëpia e saj është e rrethuar gjatë gjithë ditës nga roje të shumta, ose më saktë besimtarë që mbrojnë "profeten". As policia, as tatimorët, as organet e tjera kompetente nuk ndërhyjnë. Ndërkohë që në shtëpinë e saj, në katin e parë të një pallati në lagjen "Ali Demi" në Tiranë "profetja" me emrin Anila kryen veprimtari si një person fizik, sepse merr para për çdo "vizitë" që kryen. Pra, përfiton para dhe është në tokë e jo në qiell.

E ashtu quajtura profete ANILA MINXHA me tezat e saja hedh poshtë Kur'anin a.sh Pejgamberin a.s, me një fjalë hudh baltë mbi fenë e vetme, fe e cila është e pranuar tek ZOTI.

Duhet pasur drojë nga këta persona të pa pergjegjshëm të cilët kanë për qëllim interesat e veta dhe kënaqjen e epsheve, janë të pa moralshëm në punën e tyre ,por besoj se nuk do të kenë suk-

ses se ALL-LLAHU xh.sh e zbriti Kur'anin dhe tha se do e broj atë deri në ditën e kataklizmës(kijametit të madh) Këtu shihet qart ku All-llahu xh.sh ne disa ajete Kur'anore thotë: "Ata të cilët vetë nuk besuan dhe penguan edhe të tjerët nga rruga e All-llahut, Ai ua ka asgjësuar veprat e tyre". Në ajetin tjetër thot : Ata që besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu do t'i shtie në Xhennete nëpër të cilat rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri.

E lusim All-llahum .xh.sh të jemi edhe në pjesë e besimtarëve ,por në asnjë mënyrë në besim të shtrembur si në rastin e Anilës si profete e rejshe që të bëjmë pjesë në taborin e saj .(Zoti e mallkoftë këtë person të pa përgjegjshëm).

**Fitim Ziberi III-B
Shkolla Qendrore**

LOJËRAT E FATIT

Njerëzit dikur më parë në sytë e të tjerëve kanë vërejtur shenja të njerëzisë (sjellje njerzore) dhe qëllimit të pastër. Sot, janë të ralla shenjat, që mund të vërehen në pamjet e të tjerëve, nese do të mund të vëresh ndonjë gjë, ajo do të jetë shenjë e euros dhe e dollarit apo shenjë e ndonjë valute tjetër

të vlefshme botërore.Vrapimi i përditshëm pas pasurisë (parasë) i ka nxitur disa njerëz që të krijojnë punë fitimprurëse pa kurrfarë investimi, të vijnë në përfitime të mira, por ajo çka është më e keqja, njerëzit duke vrapuar pas kësaj pasurie e harruan krejtësisht Zotin dhe Ditën e Kiametit

dhe harruan se do të japin llogari para Krijuesit të gjithësisë.

ISLAMI NDALON
LOJRAT E FATIT

Reth lojrave të fatit siç janë: bingo, loto, bastet sportive dhe të ngjajshme me to, normat islame janë shumë



të qarta. Islami rreptësisht i ndalon të gjitha lojrat e fatit të cekura më lartë. All-llahu xh.sh. thotë: **“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveçse nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhe armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”** (El-Maide 90-91).

Shumë njerëz pyesin pse janë të ndaluara dhe çfarë të këqijash ka në to, apo burojnë prej tyre?

Duhet të dijmë se muslimani pasurinë nuk duhet ta shpenzojë në gjëra, të cilat janë të dëmshme, por duhet që pasurinë ta shpenzojë në gjëra, të cilat janë të dobishme për veten dhe për tërë shoqërinë ku sjellin rezultate të mira. Poashtu nëse dikush dëshiron t’ia merr pasurinë tjetrit, duhet t’ia bëjë me dije ose t’ia argumentojë pse ia mer dhe çka i ofron. Ata të cilët marrin pasuri nga njerëzit për këto lloje lojërash, çfarë do t’i thonë atij i cili ka blerë tiketën apo atij i cili ka shpenzuar me qindra euro duke blerë tiketa me rradhë. Pa dyshim se do t’i përqeshnin në fytyrë apo do tu thoshin se ne nuk jemi fajtorë pse ai ka vepruar kështu dhe se kjo ka qenë dëshira e tij e lirë. Shumë qartë theksohet në ajetin kur’anor, shejtani përmes këtyre veprave dëshiron të

fusë urrejtje mes njerzëve dhe t’i ndajë nga përkulja ndaj All-llahut xh.sh.

Islami e mëson njeriun të jetojë nga djersa e tij, e jo që të jetojë mbi kurriz të dikujt tjetër. Nga gjithë këto që i thamë mund të konstatojmë se All-llahu i Madhëruar e ndalon atë në të cilën ka dëm individit apo shoqëria në përgjithësi dhe urdhëron në atë çka është e dobishme.

SI ËSHTË FITUAR ASHTU ËSHTË HARXHUAR

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Si është fituar ashtu është harxhuar”, që do të thotë, në atë formë që e fiton pasurinë, hallall apo haram, ashtu në atë formë do ta harxhosh. Shumica e njerëzve kur mendojnë për paratë i shikojnë shifrat duke menduar së e tërë mirësia qëndron aty. Muslimani para se të shikojë shumën e fituar, e shikon mënyrën e arritjes të ajo shumë parash, dhe pastaj e falënderon All-llahun xh.sh. dhe lutet që ta begatojë atë fitim. Urtësia nuk qëndron në sasinë e fituar, por në atë se a ka njeriu bereqet prej saj.

Pasuria e fituar në mënyrë të ndaluar pas veti sjell shumë fatkeqësi, të cilat janë në dëm të individit. Ndoshta sot fiton para në mënyrë më të lehtë, por nesër mund t’i harxhosh në mjekimin e vetvetes apo të ndonjë anëtarit të familjes dhe të mos e shijosh bukurinë dhe kënaqësinë a asaj paraje. Paratë e fituara në bixhoz shumë shpejtë lihen në bixhoz, për këtë paraqiten probleme të shumta në familje për shkak të humbjes

së parave të fituara. Të gjithë këto shembuj janë argument se në haram nuk ka dobi.

PASOJAT E KËQIJA NGA PASURIA E FITUAR HARAM.

Fitimi haram jo vetëm që lë pas veti pasoja, por ajo bëhet shkak për mohimin e disa begative. Muhammedi a.s. ka thënë: *“Me të vërtetë All-llahu xh.sh. është i mirë dhe nuk pranon asgjë përveç të mirës”* ndërsa në një ajet kur’anor All-llahu xh.sh. thotë: **“O besimtarë ushqehuni me të mirat prej të cilave u kemi furnizuar dhe falënderoni All-llahun xh.sh. dhe vetëm Atij përuleni”** (El-Bekare 170).

Nëse dikush nuk ushqehet direkt nga ato që janë të ndaluara me Islam, por atë e blen nga të fituarit haram, bëhet haram. Imam Sujuti transmeton thënien e Pejgamberit a.s. ku thotë: *“Mishi i cili ka prejardhjen nga harami zjarrin e ka më së afërmi”*.

A thua vallë janë të majftueshëm këto argumente për t’u larguar nga kjo e keqe, që e ka kapluar popullatën islame dhe të kërkojmë furnizimin tonë në atë formë, që i ka hije muslimanit, sepse atëherë mund të mbështetemi në All-llahun xh.sh. dhe të kërkojmë nga Ai lehtësime në atë rrugë: **“... e kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare ...”** (Et-Talak 2-3)

Muzemil Osmani III-A
Shkolla Qëndrore

DEXHALLI, MYSAFIR I KËTIJ SHEKULLI

Vëllezër dhe motra, do t'ua tërheq vëmendjen me diçka shumë të rëndësishme. Po jetojmë në vitet e fundit të botës. Ne më vetëm se i kemi përjetuar shenjat e vogla të kiametit që iu paraprijnë shenjave të mëdha. Me fjalë të tjera, është konfirmuar se 95 % të shenjave të vogla i kemi përjetuar dhe shumë befas po ndeshemi me shenjat e mëdha që njëkohësisht alarmojnë për fundin e kësaj bote.

Midis shenjave të mëdha është edhe paraqitja e dexhallit, i cili do të jetë aq i rrezikshëm, keqbërës, sa që nuk ka Pejgamber të All-llahut prej të parit e deri te Pejgamberi i fundit që nuk ka paralajmëruar ummetin për ardhjen e tij.

Kjo krijesë do të ketë mundësi të mashtrrojë çdokënd që mendon se ka sadopak iman në zemrën e tij.

Mendohet se kjo gjeneratë ka shumë shanse të njohë këtë krijesë. Pejgamberi a.s. thotë: "Ai që dëgjon se është paraqitur dexhalli, le të largohet, se betohem në All-llahun do të vijë njeriu tek ai duke menduar se është besimtar dhe do ta pasojë atë..."

Në prag të ditës së kiametit, do te paraqiten dexhalle dhe gënjeshtarë që do t'ju rrëfejnë për atë që kurrë se keni dëgjuar, as ju e as baballarët tuaj, ruajuni prej tyre që të mos ju largojnë nga rruga e drejtë dhe mos t'ju mashtrajnë..."

Po ashtu Pejgamberi s.a.v.s i lajmëroi shokët e tij duke u thënë: "Kur do të paraqitet dexhalli do ta shëtisë të gjithë sipër-

faqen e tokës, e nuk do të lë asnjë fshat pa shkuar për dyzet ditë, përveç Mekkes dhe Medinës. Sa herë do të tentojë të hyjë në Medine, do të jetë një melek me shpatë në dorë që do ta pengojë dhe çdo cep është i rrethuar me melekë "...

"Medineja do të tronditet tri herë e do të dalin në shesh hipokritët..."

Enes ibën Malik transmeton

se Pejgamberi a.s ka thënë: "Dexhalli do të dalë nga çifutët e Asbahanit dhe do të ketë shtatëdhjetë mijë çifutë që do ta ndjekin..."

Po ashtu Pejgamberi a.s ka lajmëruar se në kohën kur do të paraqitet dexhalli do të ekzistojnë shtatë hyrje (porta) kryesore për në qytetin e Medines.

Nëse shikojmë vëmendshëm hartën e Medines, do të vërejmë mu ato shtatë rrugët kryesore që çojnë në Medine. Njëra portë është prej Xhiddes, njëra është prej Mekkes, e treta portë vjen prej qytetit Rabig, e katërta rrugë është nga aeroporti, dhe rrugët tjera janë nga rajoni më i afërt...

Ebu Umameh transmeton se Pejgamberi alejhi selam ka thënë " Dexhalli do t'ju thotë se është Zoti juaj, por dijeni se ju nuk do ta shihni Zotin tuaj derisa të vdisni. Dexhalli është me një sy dhe dijeni se Zoti juaj nuk është i verbër. Ai në ballë e ka të shkruar " Kafir " e do ta lexojë çdo besimtar që di të lexojë. Ai ka dy lumenj, një prej zjarri dhe një prej uji dhe dijeni se uji është zjarr dhe zjarri është ujë. Kush sprovohet me këtë le ti kërkoj ndihmë All-llahut duke lexuar fillimin e sures " Kehf " (ajete që të mbrojnë nga dëmi i dexhallit)."

Këto janë disa nga shenjat e mëdha që pohojnë se: " Edhe kësaj bote i erdhi fundi "

Zgjuhuni o muslimanë! Mos vallë presim diellin të na thotë mirëmëngjesi nga perëndimi???

**Luna Bajrami viti I
Paralelja e Femrave -
Gostivar**





ALARM, RINIA ËSHTË NË RREZIK!!!

Gjithmonë është thënë, se rinia është ardhmëria e një shoqërie, e një populli, e një shteti dhe mbi supet e saj do të barten përgjegjësitë dhe obligimet për të udhëhequr, edukuar, zhvilluar dhe për të çuar përpara bashkësinë njerëzore. Për një realitet të tillë, të gjithë jemi të bindur, por nuk mjafton bindja e prindërve tanë, për të realizuar kjo rini misionin e vet duhet paraprakisht të përgatitet e të aftësohet, të kalitet, për të ardhur në formën e duhur, që do ta bënte meritort të kësaj përgjegjësie kaq të madhe. Kur themi kështu, e kam fjalën për mospërfilljen e pjesës dërmuese të shoqërisë sonë, duke filluar nga prindërit, institucionet shkollore nga më të ulëtat e deri te më të lartat, masmediat etj, nga të cilat vazhdon një pakujdesi e madhe në edukimin e mirëfilltë të rinisë sonë.

Prindërit si institucion i parë në edukimin e fëmijës, bartin përgjegjësinë më të madhe në orientimin e drejtë të fëmijëve të tyre. Nëse fëmijës nuk i jepet edukata e drejtë në vitet e para të fëmijërisë, padyshim se ai në moshën madhore do të jetë i çorientuar. Nuk duhet të mos përfillet ndikimi i madh negativ, që po shkakton rrjeti i masmediave tona, radiot, televizionet dhe disa revista.

Në shumë radio lokale, të krijuara enkas për rininë tonë, në shumë emisione të tyre përdoret një fjalor aq i shfrenuar, aq banal dhe i poshtër, sa që fiton bindje sikur këto zëra që dëgjon dhe këta të rinj të vijnë prej ndonjë planeti tjetër, janë aq të

pa skrupuj sa që s'të besohet të kenë lindur dhe të jenë edukuar në shoqërinë tonë. Të vjen turp prej vetes kur i dëgjon bisedat e tyre aq banale, atë humor të pagdhendur që sinjalizon dhe alarmon për një rënie të përshpejtuar të vlerave morale-etike.

Kush mund të thotë se këto emisione të pakontrolluara janë në shërbim të edukimit të mbarë të rinisë sonë? - Askush, dihet që askush, por është kjo e tëra që na ofrojnë "mediat" tona, ndërsa ne heshtim. Më bën përshtypje sikur të jemi mësuar të nëpërkëmben interesat tona.

Edhe rrjetet televizive, qofshin ato lokale, a nacionale nuk janë shumë më mirë. Në mungesë të emisioneve dokumentare dhe profesionale, në ekranet e tyre shfaqin programe dhe filma serik të stërzgatur... lakuriqësia e tepruar e femrave të reja të shfaqura në ekranet tona, të manipuluar nga menaxherët e tyre, është një fenomen që vërtetë ka marrë hov të madh në jetën tonë, e tani kohëve të fundit hov marrin edhe lojërat e fatit, të udhëhequra nga njerëz, që qëllim të tyre parësor kanë fitimin pa djersë të parave ...

Sa herë në javë, në muaj ose në vit organizohet ndonjë program edukativ, si masë preventive për parandalimin e shfaqjes së dukurive negative në shoqërinë tonë? Sa emisione kemi pasur, për të alarmuar rrezikun që shkakton droga, alkooli, prostitucioni dhe të ngjashme?

Pse alkooli përdoret me të madhe nga rinia jonë?

A janë këto shenjat e "eman-



cipimit" tonë apo shenja paralajmëruese të një katastrofe të rinisë dhe shoqërisë sonë në të ardhmen e afërt? Emisionet me karakter edukativ - arsimor, me siguri do të ndihmonin shumë e më shumë në edukimin e shëndoshë të të rinjve tanë, se sa filmat e përditshëm serik me nga 100-200 episode.

Pse masmediat tona të mos kenë edhe emisione edukative-fetare? Nëse të rinjtë, të cilët janë e ardhmja jonë nuk janë të shëndoshë, nëse rinia jonë, e cila është pasuria më e madhe, zhvishet nga ndjenjat shpirtërore, fetare e morale, atëherë si mund të presim një të ardhme perspektive dhe prosperuese për shoqërinë tonë?!

Të mos harrojmë se një shoqëri, që ka shkelur normat e etikës dhe të moralit është vyshkur ashtu si druri, të cilit po iu hoq lëvorja nuk mbetet i gjallë !!!

**Nasuf Jusufi III-A
Shkolla Qendrore**



ZGJOHUNI!!!

Jeta pa dyshim është sikur një roman me plot faqe dhe me plot ngjarje duke filluar nga më të mirat dhe më mbresëlënëse e deri te ata me përshtypje të matur.

Kur flasim për këto ngjarje pa dyshim mendja na shkon te rinia, pikërisht kohën që shënon fillimin e thurjes së mirëfilltë të këtij romanit të titulluar "Jetë", kohën kur ndodhin ngjarjet më të rëndësishme, që përcaktojnë kahun rrjedhës së mëtejshme të jetës. Lexoj romanin tonë dhe e ndjej se diçka nuk po shkon si duhet, diçka po ndodh, por nuk mund ta kuptoj ç'është kjo. Shumica e të rinjve tek ne e bartin pluhurin e bardhë të pagëzuar me emrin e ftohtë "drogë", duke menduar se në këtë mënyrë do t'u largohen problemeve, por nga ana tjetër futen në probleme më të thella. Nuk janë vetëm meshkuj, por edhe një numër i madh femrash që e konsumojnë drogën.

Shkak që sjell deri te gjithë kjo është shoqëria e pa arsimuar, papunësia, mungesa e edukatës familjare, mosnjohja e vlerave fetare - morale. Gjithçka fillon duke i ofruar shoku shokut një cigare dhe përfundon në mënyrë të kobshme. Nuk di ç'është them ndoshta kanë arsye, mendojnë se jeta e një narkomani është më e mirë, por përkundrazi jeta e tyre është e zymtë dhe e errët deri në ditën kur do të marrë fund. Për këtë rrugë të mjerë gjithsesi se ndikon familja, rrethi ku jeton etj. Ah sikur të kisha forcë, që ta zhdukja gjithë këtë epidemi të mallkuar, që i ka kapluar zemrat e atyre që me dashje apo pa dashje e morën këtë rrugë të paudhë. Kam shumë për të shkruar por nga dhembja që më është vulosur thellë në shpirt, nuk kam forcë që ta shtyp edhe këtë laps të kaltër në fletë, andaj janë këto fjalët e mia të fundit.

"Rini e dashur zgjohuni, zgjohuni nga ky gjum që u ka kapluar, mos e ndiqni rrugën e atyre që gjithnjë janë të vuajtur, mos e shijoni këtë aromë të keqe, mundohuni që ti përballoni këto sfida, sepse kjo është e vetmja mënyrë e shpëtimit!!!"

**Elmedina Memedi viti I
Paralelja e Femrave - Gostiva**

DROGA DHE PROSTITUCIONI

Shoqëria shqiptare në dhjetëvjeçarin e fundit të këtij shekulli është përballuar me shumë elemente të rrezikshme, të cilët i kanë sjellë dëme, jo vetëm shoqërisë shqiptare, por edhe politikës dhe ekonomisë së saj në tërësi. Elementet kryesore të cilët kam ndërmend t'i parashtojë në këtë temë, që sipas mendimin tim vlerësohen si më problematikët. Në shoqërinë shqiptare kohët e fundit dhe në tërësi si të padëshiruara dhe të dëmshme për individë të veçantë dhe për shoqërinë, janë pikërisht droga dhe prostitucioni, të cila t'renditen në majat e problematikës jo vetëm shqiptare por edhe ndërkombëtare. Organizatat e mëdha kriminale ose të ashtuquajtura si "krimi i organizuar", të cilët merren me kontrollin e prostitucionit dhe me trafikun e drogës, gjithmonë e më shumë konkurrojnë përballë çdo lloj biznesi shqiptar e ndërkombëtar. Jo vetëm kaq, por trafiku i prostitutave u ka krijuar trafikantëve shqiptarë mundësinë e dominimit edhe në tregun e drogës.

Në mjaft raste droga dhe prostitucioni koekzistojnë, pra shoqërojnë njëra-tjetrën tek i njejt person. Është një fakt historik, që tregon lidhjen e ngushtë të këtyre dy elementeve. Në mjaft vende të Evropës Perendimore, në fillim të shekullit XX droga në përgjithësi, në veçanti kokaina, ishte e lidhur në mënyrë ekstreme me prostitucionin. Një shembull i thjeshtë me të cilin mund të nxjerrim në shesh dukshëm lidhjen e ngushtë drogë - prostitucion, është edhe stimulimi i njerit element me tjetrin, konkretisht, një përdorues i drogës, për të siguruar parat e nevojshme për drogën e përditshme ose duhet të hyjë në rrugën e krimit (vjedhje, grabitje, vrasje etj.) ose duhet të bëhet edhe trafikant droge, zakonisht meshkujt apo do të bjerë nën kthetrat e prostitucionit, që zakonisht ndodh me femrat. Në kushtet e një sistemi të shpërqëndruar apo kaotik në të cilin gjendet shoqëria shqiptare, këto dy elemente gjithmonë e më tepër fuqizohen reciprokisht me ritme të shpejta. Përhapja e organizatave kriminale shqiptare është shtrirë jo vetëm në trojet tona por edhe jashta tyre. Stimuluesit kryesorë të kësaj përhapje të gjerë drogë - prostitucion në kohë kaq të shkurtër kanë qenë dhe janë niveli i ulët kulturor, papunësia, pozita gjeografike tepër favorizuese për këto dy elemente, që kultivojnë edhe institucionet shtetërore. Në konkluzion mund të themi se këto dy elemente drogë - prostitucion dhe viktimizimi i brezit të ri prej saj, është lidhur me situatën shoqërore që përjetojnë të rinjtë, me kontradiktat midis interesave shoqërore dhe kulturore të saj, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër mungesës së mundësive e mjeteve të institucioneve dhe strukturave të shoqërisë sonë për plotësimin e tyre.

**Fitim Alili I-A
Shkolla Qendrore**





KU ËSHTË LUMTURIA?

E tërë bukuria e kozmosit, e natyrës, e ditës dhe e natës nuk të mjafton që të arrishë lumturi në këtë jetë. E tërë lumturia gjendet në qetësinë shpirtërore të cilën shumë njerëz mendojnë ta gjejnë në haram, por më kot. Ajo është mbyllur në burgun e erësirës dhe harresës e cila nuk kthehet gjersa të gjendet e vërteta e cila do të na shpie drejt kërkesës tonë shpirtërore, drejt nevojës tonë njerëzore. Kjo kërkesë do të na garantojë lumturinë tonë të kësaj bote dhe të mjedisit në të cilin jetojmë. Lumturinë e kam kërkuar aq shumë sa që jam lodhur. Jam lodhur sepse bashkë me të kam kërkuar edhe diturinë, moralin e drejtësinë.

Një ditë e gjeta, e kisha aq afër sa që kot isha lodhur, ishte pikërisht këtu, këtu në Tetovë, në Medresenë e Isa Beut. Gjatë katër viteve në këtë shkollë lumturia ka lëshuar rrënjë të thella në zemrën time. Gjithmonë dhe kudo që jam, mua më shoqëron qetësia shpirtërore, morali i lartë islam, dituria dhe besimi i fortë ndaj Krijuesit tim.

Unë jam shumë larg haramit sepse mua më shoqëron pa ndërprerë Zoti im dhe engjujt. Po, se këtë e kam mësuar në këtë çerdhe edukativo-arsimore, se ndryshe nuk do të isha unë kjo

që jam. Këtu mësojmë vlerat e larta të fesë që i besojmë, moralin e shëndoshë dhe vlerat e larta njerëzore për ballë rrethit dhe shoqërisë që na rrethon. Programi mësimor i ngjeshur në këtë shkollë, interesimi shumë i madh i profesorëve, për të nxjerrë nga mesi i kësaj rinie, një brez të përkryer në aspektin fetar, të diturisë, moralit dhe sjelljes në përgjithësi, dita ditës është duke iu afruar qëllimit. Në zemrën time, vërtetë e ndjej, se jemi duke shkuar drejt të vërtetës të cilën, e kishim humbur më parë.

Fjalët e para që iu shpallën Muhammedit a.s. ishin: "Lexo! Në emër të Zotit I cili krijoi çdo gjë. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo se Zoti yt është më bujari. Ai që e mësoi njeriun të shkruaj me pendë. I mësoi atë që nuk e dinte." Nga ajetet kuptojmë se All-llahu na dha mendjen dhe diturinë e pse të mos e shfrytëzojmë këtë dituri në emër të Tij, ta shfrytëzojmë në hallall e jo për interesat tjera të cilat na i ofron shejtani. Pra, përmes kujtesës Perëndinë dhe aftësimin tonë me dituri të shëndoshë do të jemi të lumtur në këtë dhe në botën tjetër.

Hasmije Saliu IV-B
Paralelja e Femrave - Tetovë



DITURIA-FUQI E MENDJES

Fjala "dituri" është një ndër fjalët më domethënëse, vlera e saj është jashtëzakonisht e madhe. Vlera e diturisë kuptohet më së miri nga fakti se vetëm ajo është e aftë që fuqinë potenciale të mendjes njerëzore ta kthejë në fuqi reale e vepruese, andaj është shumë e qëlluar të thuhet se dituria është fuqi e mendjes.

Njerëzit ngriten në jetë vetëm përmes diturisë, poqese një njeri do të ketë mendje të pasuruar me dituri, atëherë ai njeri do të jetë i dashur nga të gjithë njerëzit, po edhe nga ana e All-llahut xh.sh.

Dituria është një thesar i çmuar që duhet të jetë synimi i çdo kujt që dëshiron të arrijë sukses në jetë, ndërsa formula e arritjes deri te ky thesar është ngjeshja e orarit tonë me punë e mësim dhe moslënia e asnjë momenti, asnjë sekondi nga koha jonë pa shfrytëzuar. Është pikërisht rinia koha e artë, ku truti është në zenit të aftësisë për nxënie të diturive të ndryshme, prandaj ne si të rinj duhet t'i përkushtohemi maksimalisht leximit dhe mësimin.

"Të mësojmë në rini, që të kemi ardhmëri", këto fjalë janë shumë me vend, pasi është vetëm dituria e shndërruar në fuqi të mendjes, e cila e nxjerr njeriun nga errësira dhe i dhuron një jetë të ndritur. S'ka dyshim se burimi i vetëm i një ardhmërie dhe një jete të lumtur e të hareshme është dituria e fituar gjatë rrugëtimit tonë nëpër këtë botë.

Bredhja pas diturisë është urdhëri i parë kur'anor, i cili tregon rëndësinë, që Islami ia jep



SI TA SHFRYTËZOJMË KOHËN

diturisë. Vetëm veprimi në bazë të këtyre parimeve na ngrit në individ pjesëtar të shtresës më të lartë shoqërore të njerëzve të vetëdijshëm për rolin dhe pozitën e tyre në shoqëri.

Dituria është e vetmja rrugë e realizimit të ëndrrës shekullore të njeriut, pavdekshmërisë. Ajo bën të paharruar pronarët e saj, bën që emrat e dijetarëve të kujtohen edhe me shekuj pas vdekjes së tyre. Është vepra me vlera të mirëfillta që e bën autorin e saj imun ndaj kohës, që shkatërron çdo kujtim njerëzor, por që këtu i thuhet "JO", ti nuk ke të drejtë të mbulosh me petkun e harresës këtë feudal të diturisë.

Mesazhi im është vetëdijsimi i rinisë sonë se duhet shkolluar e arsimuar, sepse arsimimi nuk është përgatitje për jetë, por është vetë jeta.

Lufta për arritje të ky thesar është e mundimshme, betejat, të përditshme, ndërsa strategjinë e luftës e gjejmë në thënien e urtë: "Dita është e humbur, nëse nuk është e pasuruar me dituri të reja."

Qefajete Sherifi Viti II
Paralelja e Femrave - Shkup



Gjëja më e shtrenjtë dhe më e çmuar e njeriut, vlera e së cilës nuk matet as me ar e as me flori, që duhet të ruhet dhe duhet pasur kujdes të veçantë për të, sepse është shumë e ndjeshme dhe në moment të një pakujdesie të vogël, rrëshqet nga dora dhe tretet në pafundësi. Shumica e njerëzve duke mospërfillur, vlerën e kohës e humbin atë kot dhe janë të privuar nga dhuntia e shfrytëzimit të drejtë të saj, duke u dhënë pas veprave, të cilat jo që nuk sjellin dobi për ata njerëz, por përkundrazi shkaktojnë dëm të pashlyshëm.

Qenia njeri është për t'u habitur, kënaqet me gëzimin dhe harenë e përkohshme dhe harron se me çdo minutë të kaluar, me çdo sekondë që ik, atij i ngel aq kohë më pak për të jetuar nga jeta e tij dhe se çdo sekondë e afron edhe më shumë kah vdekja, të cilën e ka edhe më afër se damari i qafës, kah varri e bota tjetër, që për mospërfillësin e kohës assesi nuk do të jenë kopshte me lule.

Koha është tërë jeta jonë, është ymri i vërtetë i njeriut, ruajtja e saj është baza e çdo të mire, kurse humbja e saj është fillimi i çdo të keqeje. Nëse muslimani kupton vlerën dhe rëndësinë e kohës, sigurisht se do të jetë më i kujdesshëm në mënyrën se si do ta shfrytëzojë kohën dhe do të vrapojë pas punëve dhe veprave që e afrojnë tek All-llahu i Madhërishtëm.

Njeriu ka dy probleme kryesore me të cilët ballafaqohet në këtë aspekt. I pari është mosnjohja e vlerës dhe, i dyti, pozitës së lartë të kohës dhe i dyti është moslogaritja e pasojave të veprave, të cilat i kryejnë, kështu që shpesh bien në grackë dhe bëjnë vepra, prej të cilave duhet të largohen. Vazhdimisht qëllimi le të jetë për të bërë mirë, po edhe sikur epilogu përfundimtar të jetë negativ.

Kur'ani dhe Sunneti i kanë dhënë rëndësi të madhe kohës dhe këtë e shprehin në lloj-lloj formash dhe mënyrash. All-llahu xh.sh është betuar në të dhe në disa pjesë të saj në Kur'an, siç është dita, nata, mëngjesi, paradita etj. Ai na siguron se të gjithë njerëzit, që nuk janë të vëmendshëm ndaj kohës, një për një janë të gjykuar në humbje dhe thotë në librin e tij: "Pasha kohën. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Përveç atyre që besuan dhe bëjnë vepra të mira..." (El-Asr 1-2). Fakti që All-llahu xh.sh. betohet në të na bën të qartë vlerën e kohës, pasi pa hamendje se për tu bërë diçka objekt i betimit të Zotit, duhet të ketë vlerë jashtëzakonisht të madhe. Mënyra e vënies në pah të vlerës dhe dobisë që buron prej sendi përmes betimit në të, është një nga metodikat e rralla të Kur'anit Famëlartë.

Pejgamberi a.s. ka sqaruar se koha është dhunti prej All-llahu xh.sh. andaj edhe duhet falenderuar Atë, për këtë dhunti, përndryshe ajo do merret dhe tërhiqet prej atij robi përbuzës ndaj mirësisë hyjnore. Mënyra e vetme e falënderimit ndaj kësaj dhuntie, është shfrytëzimi i saj në vepra të mira dhe të dobishme. I Dërguari a.s. ka thënë: "Shumica e njerëzve dy dhunti nuk i perfillin: shëndetin dhe kohën e lirë." (Transmeton Buhariu).

Vëllezër dhe motra të nderuar, nxitoni, bëni një kthesë në jetën dhe filloni ta shfrytëzoni drejt kohën dhe jetën tuaj duke e kaluar atë me adhurime dhe vepra, që do t'u sjellin dobi edhe atyre që ju rrethojnë! Largohuni zvarritjes dhe përtacisë, sepse në varre ka shumë njerëz të vrarë nga fjalët "do ta bëj nesër"...

Vildan Mustafa viti III
Paralelja e Femrave - Shkup



KUR'ANI DHE SHKENCA

Para se të themi diçka rreth të vërtetave shkencore që gjenden në Kur'an, duhet patjetër të sqarojmë se Kur'ani është libër besimi dhe udhëzimi, i zbritur prej All-llahut xh.sh. për t'i nxjerrë njerëzit prej errësire në dritë, kurse të vërtetat shkencore që gjenden në Kur'an nuk duhet të merren si qëllim i zbritjes së tij. Por Kur'ani zbriti me këto të vërteta shkencore që të vërtetohet se është fjalë e All-llahut xh.sh. këtë na e bën me dije ajeti kur'anor ku All-llahu xh.sh thotë: **“Libër, ajetet e të cilit janë radhitur (në mënyrë të përsosur, njëkohësisht) edhe shkoqitur nga i Dijshmi i të gjitha çështjeve në hollësi”** (Hud:1.)

Prej mrekullive të Kur'anit është edhe përputhshmëria e plotë mes zbulimeve shkencore dhe ajeteve kur'anore. Të gjitha zbulimet shkencore që janë vërtetuar gjer më tani, nuk kanë rënë në kundërshtim me asnjë ajet kur'anor. Kjo vetvetiu është mrekulli. Kur'ani jo vetëm që është në përputhshmëri me zbulimet shkencore që janë të vërtetuara, po Kur'ani për të

vërtetat shkencore na informon para 14 shekujve kurse shkencëtarët në dekadat e fundit kanë bërë zbulime shkencore të vërtetuara. Të paraqesim disa shembuj rreth kësaj çështje:

KRIJIMI I FOSHNJËS NË BARKUN E NËNËS

Të gjitha njohuritë, për zhvillimin e embrionit në mitër të nënës, janë rezultat i hulumtimeve shkencore të katër dekadave të fundit, këto njohuri të reja ndihmuan në kuptimin e informimeve kur'anore para 1400 vjetëve.

Deri para do kohe mendohej se muskujt dhe eshtrat formohen dhe zhvillohen bashkërisht, por hulumtimet e reja treguan për një të vërtetë, për të cilën njerëzit ishin të pa vetëdijshëm. Në embrion së pari formohen eshtrat kurse përreth eshtrave formohen muskujt. Për këtë të vërtetë, që shkenca e ka zbuluar para një kohe shumë të shkurtër Kur'ani informon qysh para 1400 vjetëve, ku në një ajet kur'anor All-llahu xh.sh. thotë: **“Më pas, atë pikë uji e bëmë**

copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). **I lartë është All-llahu, më i miri Krijues”.** (Mu`minunë:14). Hulumtimet shkencore rreth lindjes tregojnë se foshnja në barkun e nënës kalon nëpër tri faza. Nga një ndër librat bazë që ka të bëjë me embriologjinë **“Bays of human embryology”** kjo e vërtetë sqarohet kështu: Jeta në mitër përbëhet prej tri fazave: 1. Pre-embriionik (18 ditët e para), 2. Embriionik (deri në fund të javës së VIII-të), 3. Fetal (prej javës së VIII-të e deri në lindje).

Këto dituri që janë rezultat i hulumtimeve shumë vjeçare dhe i teknologjisë moderne, në Kur'anin famëlartë janë treguar para 1400 vjetësh. Tri fazat në barkun e nënës në një ajet kur'anor tregohen kështu: **“Ai u krijon juve në barqet e nënave tuaja, krijim (etapë) pas krijimi në tri errësira. Ky është All-llahu, Zoti juaj, vetëm i tij është**



pushteti, nuk ka zot tjetër pos Tij. E, si pra, i shmangeni (adhurimit të Tij)? (Ez Zumer:6)

QARKULLIMI I UJIT NË NATYRË

Në vitin 1580 Bernard Polys ishte i pari, i cili bëri përshkrimin e parë të qarkullimit të ujit në natyrë. Njerëzit më herët nuk e kanë njohur burimin e ujërave nëntokësore dhe pohonin se ujërat e oqeanëve lëvizin nën ndikimin e erërave duke u futur në brendësi të tokës dhe pastaj ato ktheheshin në oqeanë përmes rrugës së humnerës. Kjo ide dominonte që nga koha e Platonit (Tartaros). Në shekullin XIV mendimtari Dekarti besoi në të, dhe në shekullin XIX dominoi teoria e Aristotelit sipas së cilës uji ishte dendësuar në shpellat e ftohta malore dhe formonte liqene nëntokësore, të cilat furnizonin burimet dhe krojet me ujë. Sot më na është i njohur procesi i filtrimit të ujit të shiut, i cili bie nga qielli dhe shpërndahet në tokë nëpër burime.

Kur'ani Fisnik na e përshkruan qarkullimin e ujit duke thënë: **“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndanë në tokë nëpër burime, mandej me të mbijnë bimë të llojeve të ndryshme.”** (Zumer, 21) All-llahu xh.sh. e përshkruan se si uji avullohet nga oqeanet dhe nga avulli formohen retë, të cilat lëvizin dhe kur bashkohen (bashkëdyzohen me energji të kundërta) lëshojnë shiun, formohen liqene e lumenj, të cilët duke rrjedhur kthehen përsëri në oqeanë. Kështu vazhdon qarkullimi i ujit në natyrë, Zoti i Plotfuqishëm thotë: **“Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën**

edhe si frikë, e edhe si shpresë dhe nga qielli lëshon shi e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në të ka argumente për një popull që di të mendojë.” (Rrum, 24)

“Ne lëshuam me masë ujin nga qielli dhe atë e përqendrojmë në tokë. Po, Ne kemi mundësi edhe ta humbim atë (ujin).” (Mu'minun: 18)

DIELLI SILLET RRETH BOSHTIT TË VET

Në vitin 1981 dijetarët kanë menduar se dielli nuk rrotullohet rreth boshtit të vet, kurse sot të gjitha librat, që merren me këtë çështje, përmendin dhe shpjegojnë se dielli sillet rreth boshtit të vet. Kjo sot, mund të shihet dhe vërtetohet përmes aparateve të ndryshme, me të cilat shikohet dielli pa u dëmtuar sytë e njeriut dhe mund të vërehet lëvizja e diellit rreth boshtit të vet. Shkenca ka arritur të zbulojë se dielli një rrotullim të plot e bënë për 25 ditë. Ndërsa, All-llahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: **“Ai është që krijoi natën e ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë.”** (Enbija: 33.) **“As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata para ditës, po secili noton në një galaksion.”** (Jasin: 40.)

Fjala “jesbehun”, notojnë është nxjerrë nga folja “sebeha” që ka kuptimin për të lëvizur. Dhe ajo përdoret si shprehje për lëvizjen e çdo trupi në çdo mënyrë, qoftë ajo lëvizje e këmbës së dikujt që ec, ose veprim i të notuarit në ujë. Por, kur folja “sebeha” – lëvizje përdoret për trup qiellor (siç është dielli) nuk ka kuptimin e lëvizjes nëpër kozmos, por rrotullimin rreth boshtit të vet.




Figura 11: Nebula Laguna është një re e gazit dhe pluhurit rreth 60 vjet drite në diametër. Është ngacmuar nga rrezatimi ultraviolet i yjeve të nxehtë që janë formuar rishtas brenda korpusit të saj. (Horizons, Exploring the Universe, Seeds, plate 9, nga Association of Universities for Research in Astronomy, Inc.)

ORIGJINA E UNIVERSIT

Kozmologjia moderne tregon qartë se në një kohë të caktuar i gjithë Universi nuk ishte gjë tjetër, veçse një re e dendur dhe e nxehtë “tymi” (1). Ky është një nga principet bazë e të pakundërshtueshme të Kozmologjisë Standarde Moderne. Shkencëtarët tani mund të vëzhgojnë yje të reja duke u formuar prej mbetjes së këtij “tymi” (fig. 10, 11).

Të gjithë yjet vezullues që ne shikojmë natën kanë qenë, ashtu si gjithë Universi, pjesë e “tymit”. Zoti thotë në Kuran: **“Pastaj Ai iu kthye qiellit, i dli ishte tym..”** Fussilet 11. Për shkak se toka dhe qielli janë formuar nga i njëjti “tym”, ne arrijmë në përfundimin se ata ishin një, më pas ato u formuan dhe u ndanë. Zoti thotë: **“A nuk e dinë ata që nuk besojnë se qielli dhe toka ishin një e pastaj Ne i ndanë ato...?”** El Enbija 30.

Muamer Rexhepi III-A
Shkolla Qendrore



NDIKIMI I KUR'ANIT NE BOTË

Falënderojmë All-llahun dhe e lartësojmë Atë, që e krijoi njeriun dhe i fali dhunti të panumërta dhe i mësoi atë që nuk dinte.

Neve muslimanëve, Zoti ynë na ka nderuar me më të mirin e librave të shpallur, siç na ka nderuar me më të mirin pejgamber të dërguar, sikurse thotë në Kur'an:

"A nuk e kuptoni se ne ua shpallëm librin në të cilin gjendet krenaria juaj" (El-Enbija :10). Paqja dhe mëshira e shpëtimit qofshin për atë, që si mrekulli pati Kur'anin, që morali i tij ishte Kur'ani, që brengën e shpirtit ia largoi vetëm Kur'ani.

Ne muslimanët jemi të vetmit që kemi në duart tona dokumentin qiellor në të cilin fjalët e fundit të ardhura për udhëzimin e njerëzimit, janë të ruajtura nga çdo ndryshim e shtrembërim, qoftë në shprehje apo kuptim, sepse All-llahu xh.sh e mori përsipër ta ruajë këtë libër, duke mos ngarkuar askënd, siç thotë në Kur'an: " Ne me madhërinë tonë e shpallëm Kur'anin dhe ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij" (El-Hixhr: 9)

All-llahu xh.sh e shpalli Kur'anin, që ta orientojë njerëzimin drejt qëllimit më të lartë dhe drejt rrugës më të qartë. Ai thotë: " Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërtetë..." (El-Isra :9). Vargjet e tij shpjegohen, komentohen si dhe këndohen. Kur'ani është një libër madhështor, nëpërmjet të cilit njeriut i ndryshohet morali, i pas-trohet shpirti si dhe ka aftësinë të zbusë zemrat jo vetëm të besimtarëve, por edhe të jobesimtarëve. Shembull për këtë e kemi rastin e Omerit r.a, i cili me dëgjimin e leximit të Kur'anit nga motra e tij e pranoi Islam. Kjo ishte realizim i lutjes së Pejgamberit a.s i cili u lut që Omeri r.a, ta pranojë Islam, që ai të ndihmojë në forcimin dhe përhapjen e Fesë Islame, si dhe në shpëtimin e njerëzve nga dënimi. Pra këtu shihet si Kur'ani ndikoi te

Omeri r.a dhe nga një njeri shumë agresiv, u bë një njeri i butë, zemra e tij, prej një zemre të ngurtë, u bë një zemër ledhatuese.

Omeri r.a, gjithmonë e ndiqte Pejgamberin a.s. Një ditë ai e dëgjoji Pejgamberin a.s duke lexuar Kur'an. Tregon vetë Omeri r.a: "Teksa dëgjoja, po mendoja në vete se këto fjalë, që po i lexon, janë të ngjashme me vjershat. Në atë moment Muhammedi a.s. po lexonte: "Ato nuk janë fjalë vjershëtari, të paktën jeni ju që besoni!" (El-Hakka: 41) Atëherë mendova, janë fjalë të një fallxhori. Në atë çast dëgjoja se Muhammedi a.s lexonte: "As fjalë të një fallxhori, të paktën jeni ju që kujtoheni!" (El-Hakka: 42). "Atëherë pyeta veten çfarë është kjo?" dhe në çast e dëgjoja të lexojë: "Është shpallje nga Zoti i botërave!"(El-Hakka: 43). Kur dëgjoja këtë m'u drodh trupi dhe filloi të më bëjë më shumë përshtypje Islami.

Kur'ani nuk ndikoi vetëm te një individ, por ai pati ndikim të madh edhe në shoqërinë arabe, e cila para ardhjes së Kur'anit besonte në idhuj të ndryshëm. Ata ishin shmangur krejtësisht nga besimi dhe adhurimi i drejtë. Më tepër i përmbaheshin traditës dhe zakoneve të tyre se sa anës fetare. Ata i adhuronin idhujt që i bënin nga hurmat, drunjtë dhe gurët e ndryshëm. Secili fis kishte idhullin e vet. Kështu numri i idhujve rreth Qabes kishte arritur mbi 300. Përveç kësaj, kishin edhe disa tradita dhe vese të këqija jonjerëzore. Siç ishin: pirja e alkoolit, bixhozi, plaçkitja, prostitucioni, shitja e skllervëve e mbi të gjitha, dukuria më e tmerrshme ishte varrosja e foshnjave të gjinisë femërore për së gjalli. Me ardhjen e Kur'anit i cili përmban fakte bindëse shumë fise arabe dalë ngadalë pranonin Islam. Dikush duke e dëgjuar Kur'anin i zbutej zemra, po në atë çast e pranonte Islam, poashtu

kishte njerëz me personalitet të madh, të cilët e pranonin Islam dhe pastaj i gjithë populli, tek i cili e ai gëzonte autoritet, nga ndersh-mëria e tij e pranonin Islam. Pra edhe këtu shihet qartë se si Kur'ani ndryshoi shumë shoqëri arabe dhe shpëtuan nga dënimi i All-llahut xh.sh.

Çdo ditë jemi dëshmitarë se si Kur'ani me ajetet e tij të cilat janë fakte bindëse, ndriçon vende të reja dhe Islami përhapet edhe në vise ku më parë nuk ka pasur muslimanë. Katërmbëdhjetë shekuj më parë, Zoti zbriti Kur'anin për ta udhëzuar njerëzimin në rrugën e drejtë. Që nga dita e zbritjes së tij e deri në Ditën e Gjykimit, ky libër i Shenjtë do të mbetet udhëzues i vetëm për njerëzimin. Stili i paarritshëm gjuhësor dhe urtësia e përkryer që ndeshen në Kur'an janë një provë e qartë e burimit hyjnor të këtij libri. Por evidencat që provojnë saktësinë e Kur'anit nuk mbarojnë me kaq: një nga këto evidenca është përmendja e një numri faktesh shkencore që janë zbuluar vetëm në saje të teknologjisë së shekullit XX, ndërkohë që Kur'ani ka zbritur rreth 1400 vjet më parë. Sigurisht që këto fakte, as që mund të imagjinoheshin në kohën e zbritjes së Kur'anit, gjë që e thekson akoma më tepër burimin hyjnor të Tij, gjë që bën këtë ndikim tejet natyror.

Ndikimi i Kur'anit do të vërehet edhe në kohët e ardhshme, atëherë kur shkenca dhe mendja do të avancohet më shumë, atëherë kur horizontet do të hapen dhe të qartësohen më tepër. Sikur që ai ka ndikuar në zhvillimin e të menduarit të njeriut në kohët kur nuk çmohej njeriu, pra në shek.eVI, ai gjithsesi, përsëri, ka forcën që të ndikojë edhe te njeriu i kohëve të sodit, i cili e ka humbur vetveten në materializëm dhe injorancë shpirtërore.

Nazlije Alija III-B
Paralelja e Femrave - Tetovë



MUHAMED ef. ISENI (1948 - 2007)



Ish drejtori i S H . M . I . "Medreseja Isa Beu" Muhamed Iseni, i diplomuar në Fakultetin Filozofik dega Sheriati Islam p r a n ë Universitetit të Bagdadit, u lind në fsh. Reçiçë

më 28 mars të vitit 1948, ku edhe e kreu shkollën fillore, e shkollën e mesme e kreu në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë dhe Fakultetin në Bagdad. Muhamed Iseni siç quhej nga gazetat e përditshme si funksionar i lartë i BIM, si pishtar i mësimit fetar, njihej me veprimtari të gjerë. Rrugëtimin për në detyrat e shumta udhëheqëse Brenda organeve dhe institucioneve të Bashkësisë Islame, e filloi si imam i fshatit, për t'u bërë referent i Muftinisë së Tetovës, kryetar i Shoqatës Ilmije të Tetovës dhe më vonë edhe Mufti i Muftinisë së Tetovës.

Pas suksesit në nivel lokal ai ngrihet në nivel republikan duke qenë anëtar i Kuvendit të BIM dhe më pas edhe kryetar i Shoqatës Ilmije në nivel të Maqedonisë. Detyra e fundit me të cilën u ngarkua Muhamed Iseni ishte posti i drejtorit të SH.M.I."Medreseja Isa Beu" - Shkup, post në të cilin nuk qëndroi gjatë, pasi aq i lejoi jeta e tij e cila mbaroi më 24 korrik 2007. Ndonëse periudhë e shkurtë koha e udhëheqjes së tij në Medrese, mund të quhet periudhë e rëndësishme, ku filluan reforma të shumta në të mirë të modernizimit të këtij institucioni dhe ngritjen e nivelit arsimor, reforma që po vazhdojnë të aplikohen edhe sot.

Muhamed Iseni i cili ndërroi jetë më 27 korrik 2007, u varros në vendlindje në prani të një numri të madh nxënësish, kolegësh, miqsh dhe dashamirësh të shumtë të tij.

**Abdusabur Abdurahmani
I-A Shkolla Qendrore**

NUREDIN ef. AHMEDI (1955 - 2008)



I lindur ne fsh. Xhepçisht të Tetovës, rrzë malit Sharr, më 14.02.1955, ku kreu shkollën fillore në vendlindje, i shtyrë nga shpirti i etur për Islam, për të kontribuar në mëkëmbjen e tij, nga zemra e stolisur me ndjenjat më të pastra fetare e vazhdoi shkollimin e mesëm në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë, ku u njoh nga afër me vlerat e larta të Islamit. Studimet i vazhdoi në

Universitetin e famshëm El-Ehzer në Kairo të Egjiptit, ku u regjistrua në Fakultetin Filologjik, dega Kulturë, Histori dhe Civilizim Islam. Ky pjesëtar i gjeneratës së hershme të kuadrove të mirëfillta nga bota arabe, i përgatitur kthehet në vendlindje, ku në vitin 1986 u punësua në Medresenë "Isa Beu" në Shkup si ligjërues i lëndës së Historisë dhe Civilizimit Islam.

Aty filloi veprimtaria e këtij mësimdhënësi të shquar, këtij veterani të arsimit që kontribuoi në zhvillimin e arsimit fetar, që ndihmoi ngritjen dhe mëkëmbjen e kulturës islame . Autor i disa librave ndër të cilat veçojmë librat e Historisë Islame për vitin I, II, III dhe IV të Medresesë, mundësoi realizimin e tërësishëm të plan-programit të shkollës nga njëra anë dhe nga ana tjetër lehtësoi dukshëm punën e nxënësit duke i dhuruar tekste profesionale shkollore të lëndës në fjalë.

Veprimtaria e këtij pishtari nuk kufizohej brenda lëndës që ai ligjëronte, prof. Nuredin Ahmedi, kujdestar i shumë gjeneratave, angazhohej në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të institucionit, të cilit ia kushtoi jetën dhe të gjeneratave që arsimoheshin në të. Rezultati i punës së tij doli në shesh me fillimin e botimit të revistës "Ikre", kësaj reviste, ku nxënësit e kësaj shkolle tanimë 16 vjet me radhë promovojnë vlerat dhe aftësitë krijuese përmes botimit të punimeve të tyre. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij që iniciuan dhe mundësuan botimin e kësaj reviste, e aftësuan atë që tu bëjë ballë sfidave të kohës, për të qenë sot revista e vetme e nxënësve të shkollave të mesme në gjuhën shqipe në vend. Prof. Nuredin Ahmedi në moshën 53 vjeçare, më 30 maj të vitit të kaluar, i la nxënësit e tij në vit të dytë dhe ndërroi jetë. U varros në vendlindje, në prezencë të të gjithë nxënësve të SH.M.I." Medreseja Isa Beu" dhe një numri të madh ish nxënësish të kësaj vatre. Nuk munguan kolegët e tij, udhëheqësit e Bashkësisë Islame, hoxhallarë të shumtë, krahas familjarëve, miqve dhe shokëve, që me lutje All-llahut xh.sh. e përcollën këtë veteran të mësimit islam.

**Arsim Idrizi I-B
Shkolla Qendrore**



VEHABIZMI, MOLLA E KALBUR, QË RREZIKON T'I KALBË EDHE TË SHËNDOSHAS

Dikush e quan komplot kundër shtetit Islam, dikush e quan fitne të futur në botën Islame, ndërsa themeluesin e kësaj lëvizjeje, njeri me ide të skajshme, të shfrenuara e të prira për devijim, që fshihet pas maskës së reformës. Ithtarët e tij e quajnë reformatör të pashembullt, ndërsa ai, veten e shpall për ripërtrirës të tevhidit (monoteizmit) të Islamit burimor, të humbur për 600 vjet të tëra. Është fjala për lëvizjen vehabite dhe themeluesin e saj Muhammed ibën Abdu'l-vehhabin, që si për ironi rrjedh nga një familje dijetarësh Islam siç ishin babai i tij, kadi hanbelit në fshatin ku jetonte dhe vëllai i tij Shejh Sulejmani. Në të vërtetë një figurë e zymtë si ky, as që meriton të përmendet pasi nuk është as i pari e as që do të jetë i fundit, por dëmi, që ai i shaktoi Islamit dhe shoqërisë muslimane të Hixhazit janë të papara gjer në atë kohë, kështu që na imponohet të flasim për lëvizje dhe persona të këtillë, që për fat të keq, por sipas përcaktimit hyjnor janë sfidat me të cilat duhet të përballet Islami burimor.

Se cili nga epitetet e lartshënuara, i përgjigjet më së miri kësaj lëvizjeje, si dhe personalitetit dhe veprës së Ibën Abdu'l-vehhabit, teoricienit me emrin e të cilit emërtohet kjo lëvizje, ju lëmë të vlerësoni ju, pas asaj që do t'juja parashtrijmë rreth paraqitjes, metodologjisë dhe mënyrës së zhvillimit të Vehabizmit dhe rreth jetës e veprës së Ibën Abdu'l-vehhabit

në rreshtat në vijim.

Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm mesazhin tonë dhe për ta argumentuar tezën se Vehabizmi paraqet rrezik edhe për Islamit burimor të trevave tona, ju rrëfejme nga disa aspekte, të ndara veç e veç:

PERSONALITETI I DEFORMUAR DHE I DEVIJUAR IVETË IBËN ABDU'L-VEHHABIT

Themeluesi i vehabizmit, Muhammed ibën Abdu'l-vehhabi, u lind në Ujejne në afërsi të Rijadit, në fshatin Nexhd, në vitin 1115 hixhrij. Edhe nga nëna edhe nga babai rrjedh nga një familje e njohur, Temim ibën Murr ibën Adnan që ka dhënë kontribut të madh për Islamit. Babai i tij ishte kadi hanbelit në fshat dhe nga ai e ka mësuar fikhun hanbelij, pastaj tefsirin, hadithin dhe shkencat e tjera fetare. Në moshën dhjetëvjeçare bëhet hafidh i Kur'anit.¹ Gjatë udhëtimeve të shumta që ai i bëri më vonë në jetën e tij, u njoftua me doktrina e lëvizje të ndryshme dhe mori mësim nga mësues të shumtë, prej të cilëve ndikim më të madh në idetë e tij pati lëvizja e Ibën Tejmijjes në shek. XIV dhe nxënësit të tij Ibën Kajjim el-Xhevzi, të cilin ai e ndoqi në masën më të madhe të mundur. Në vitin 1153 H. ai kthehet në krahinën Nexhd, në fshatin Hurejmli ku ishte vendosur i ati i tij, për të mbajtur ligjerata publike, me qëllim të përhapjes së ideve të tij. Mirëpo ai nuk hasi





në mirëkuptim tek dijetarët e tjerë e as tek babai dhe i vëllai i vet, të cilët duke qenë dëshmitarë të fjalëve dhe veprave të Ibën Abdu'l-vehhabit, prognozuan për skajshmërinë e ideve të tij dhe prirjen për lajthitje. Ata duke druajtur për pasojat, që mund të shkaktonte ai në shtresën e popullatës së paarsimaur, e kritikuan ashpër atë dhe ua tërhoqën vërejtjen të tjerëve prej tij, shumë shejhë dhe dijetarë medinas kanë folur për të: "Ky do të lajthit", apo "All-llahu me të në lajthitje do t'i dërgojë disa njerëz, qoft larg prej nesh!", madje vëllai Shejh Sulejmani ka shkruar edhe një vepër në kundërshtim të ideve të shfrenuara të Ibën Abdu'l-vehhabit,² por pasi e panë ngurtësinë e mendimeve të tij, e dëbuan nga fshati.

Pas dëbimit pati një avanturë që përfundoi pa sukses, në Ujejne, ndonëse në fillim u përkrah nga emiri i Ujejnes, Uthman ibën Ma'mer, por më vonë u detyrua të largohet dhe shkon në fshatin Der'ijje, ku lidhi marrëveshje me familjen saudite, në vitin 1744, që ai ta përkrahë ideologjikisht luftën e tyre për marrjen e territoreve prej Perandorisë dhe Hilafetit Osman, ndërsa ata, ta përkrahin ushtarakisht dhe t'i mundësojnë t'i përhap me dhunë idetë dhe mësimin e tij në vendet e pushtuara, që është kundërshtim i hapur i metodës së thirrjes Islame, të cilën e proklamoi ajeti kur'anor: "**Nuk ka dhunë në fe**" (El -Bekare: 285).

Nga e tërë kjo shihet qartë personaliteti i shprehur Islam i vetë themeluesit të kësaj lëvizjeje, pasi ashpër u kundërshtua nga të gjithë dijetarët e kohës. Ai ndër të tjera, në vitin 1787 prezenton në shpalljen e administratës së pavarur shtetërore nga emiri

Abdulaziz, i cili vetshpallet halif dhe vendos sistemin trashëgues të sundimit, me çka i siguron të birit hilafetin pas tij dhe njëherit i siguron vazhdimësi marrëveshjes me Abdu'l-vehhabin, i cili si duket harron thënien e Pejgamberit a.s.: "**Nëse u jepet zotimi (bej'at) dy halifëve, nbytnë të fundit prej atyre dyve.**" (Hadithi sherif).³

PRAPAVIJA POLITIKE E LËVIZJES

Në një kohë kur Perëndimi, kishte vendosur që me çdo kusht, pa marrë parasysh mënyrën dhe mekanizmat e nevojshme, ta shkatërrojë Islamit dhe institucionin e hilafetit, që zë fill nga koha e Muhammedit a.s.dhe i cili ishte pengesë në realizimin e qëllimeve të tyre të errëta, copëtimit të muslimanëve, okupimit të territorit të tyre dhe plaçkitjes së pasurisë së tyre.

Ata provuan të ngjallnin lëvizje nacionaliste brenda vet shtetit Islam, ku viset e para në të cilat u testua kjo formulë, ishin viset ballaknike, nga ana tjetër Franca fillon invazionin e saj ushtarak drejt trojeve arabo-Islame, ashtu që në vitin 1797 e merr Egjiptin, pastaj vazhdon drejt Palestinës, por tentativa për rrënimin e hilafetit si formë Islame e qeverisjes, dështoi.

Armiqtë e përbetuar të Islamit nuk e lanë me kaq, ata mundoheshin që të gjejnë mënyrën e duhur për realizimin e synimeve të tyre, me ç'rast ndër morën disa aktivitete strategjike, për sulm nga prapavija. Për ta kuptuar se cila ishte lëvizja më dobiprurëse për ta, e citoj Abdulkadim Dhellumin, i cili thotë: "**Potez i suksesshëm që Perëndimi e tërhoqi ishte themelimi i një lëvizjeje fetare e dila në formën e saj të jashtme do të dukej Islame, e në esencë detyra e**

kësaj lëvizjeje do të ishte që vendet Perëndimore, nëpërmjet saj, ta marrin pushtetin nbi muslimanët dhe ta rënojnë hilafetin.

Anglia nëpërmjet njeit të saj, Abdu'l-aziz ibn Muhammed ibn Saudin, tentoi ta dëmtojë dhe dobësojë shtetin Islam përbrenda. Në brendi të hapësirës së Arabisë erdhi deri te formimi i lëvizjes vehabite. Anglezët e ndihmuan në armë dhe para, në mënyrë që të mund ta ngrëjnë zëin dhe armën kundër halifit."⁴

Kjo edhe ndodhi, Anglia e ndihmoi lëvizjen vehabite në çdo luftë të zhvilluar, ndërsa nga ana tjetër gjithçka sinkronizoi shumë mirë, ashtu që në kohën kur vehabistët sulmonin, Perandoria Osmane sulmohej edhe nga Perëndimi. Sa për ilustrim, ju sjellim vitin 1804, kur vehabistët një vit pas pushtimit të Mekes, e sulmuan dhe e morën edhe Medinen. Po në atë vit Karagjorgje ngriti kryengritje kundër Turqisë.

KUNDËRSHTIMI I DOKTRINËS SË TYRE ME BURIMET E ISLAMIT

Që në paraqitjet e para publike Ibën Abdu'l-vehhabi, i kundërshtoi dijetarët e mëdhenj të fesë dhe arriti deri në atë shkallë që t'i shpall ata për kafira (jobesimtarë). Ai shumë çka nga Islami shpalli për kufër (mosbesim) dhe shirk (politeizëm), siç ishte ndalimi i tevessulit⁵ dhe vizitës së varrit të Pejgamberit, me çka vjen në kundërshtim të hapur me hadithe të shumta. Bile ai shkon aq larg sa që të gjitha ajetet që flasin për mushrikët (politeistët) e Mekes, ua përshkruan po thuaj gjithë botës Islame, që nuk e ndiqnin mësimin e tij të shtrembëruar të Islamit. Kjo e irriton tejmase Sejjid Ahmed ibn Zejn Dehlanin (Mufti të Mekkes), i cili në librin "Fitneja



vehabite” thotë: “E si mund t’i lejohet Ibn Abdu’l-vehabit dhe atyre që e ndjekin, që t’i barazojnë besimtarët (mu’minët) monoteistë me ata që janë jobesimtarë (mushrikë) dhe që besojnë në hyjnishmërinë e idhujve të tyre???”

Vetëm po sjell disa shembuj, që vërtetojnë lejueshmërinë e asaj nga e cila ndalon Ibën Abdu’l-vehabi:

Lejimi i tevessulit – Ekziston transmetimi sahih (autentik) se Muhammedi a. s. kur ka vdekur Fatime bint Esed, nëna e Ali ibn Ebi Talibit, se ai me dorën e tij të ndershme e ka lëshuar në varr dhe e lexoi duanë: “All-llahu im, falja nënës sime Fatime bint Esed dhe bënja varrin të gjerë me të drejtën e Pejgamberit Tënd dhe të pejgamberëve para meje. Ti je më i mëshirshmi nga të mëshirshmit.”

Gjithashtu ekziston transmetimi sahih se Ademi a. s. ka bërë tevessul me Pejgamberin tonë a. s. Kur hëngri nga frutat e drurit të ndaluar, Ademi a. s. e pa emrin e tij të shkruar në Arsh, në dyert e Xhenetit dhe në anën e engjëjve, dhe e pyeti All-llahun për të. All-llahu i tha: “Ky fëmijë është pasardhës i yti, sikur të mos ishte ai

as ty nuk do të të krijoja.” Atëherë Ademi a. s. ka thënë: “O All-llahu im, pashë hyrmetin tënd ndaj këtij fëmije, mëshiroju ndaj këtij prindi.” Atëherë është ftuar: “O Adem, sikur të kishe kërkuar falje me Muhammedin

për të gjithë banorët e qiejve dhe Tokës, ne do ta jepnim.”⁶

Lejimi i vizitës së varrit të Muhammedit a.s.-

Transmetohet nga Ibni Umeri r.a. se Muhammedi a.s. thoshte: “Kush viziton varrin tim i bëhet obligim shefaati (ndërmjetësimi) im”, këtë hadith Hafidh Ibën Ali es-Sukni e njeh si sahih (të shëndoshë) dhe e shënon në librin e tij “Sunen Es-Sihah”

Ibën Adiu përcjell në librin e tij “El-Kamil”, me zinxhir të shëndoshë tranmetuesish që arrin deri te Ibni Umeri r.a. që tregon se Pejgamberi a.s. thoshte: “Kush bën haxhin dhe nuk më viziton më ka lënduar”⁷

Edhe në shumë çështje tjera Vehabizmi vjen në kundërshtim me Kur’anin dhe hadithin, por nuk mund t’i cekim të gjitha këtë punim të shkurt dhe amatoresk.

SHKATËRRIMI I PAPARË I TRASHËGIMISË KULTURORE ISLAME

Militantizmi ekstrem është çështja, të cilën intelektualët Islamë më së shumti ia zënë për të madhe vehabizmit, ndërsa shpalljen e luftës së shenjtë kundër të gjithë atyre që nuk ishin të një mendje me ta, e konsiderojnë jashtë çdo mase. “Ata ku depërtonin aty shkretinin, plaçkitnin në emër të presë së luftës dhe i mbysnin të gjithë kundërshtarët, sepse i shpallnin për renegatë dhe heretikë.”⁸

Vehabistët kur e pushtuan

Medinen, shkatërruan dhe asgjësuan tërë atë trashëgimi që e quanin objekt shirk (politeizmi), duke u thirrur në emër të eliminimit të bid’ateve (risive). E rrënuan kuben mbi varrin e Pejgamberit a.s., e plaçkitën huxhrën (vendin ku gjendej trupi i Muhammedit a.s.) dhe gjithë ç’kishte aty, rrënuan tyrbet në varrezat më të njohura siç ishin Bekia Medinase, varrezat e dëshmorëve të Uhudit etj.⁹

Shejh Jusuf Rifai ka numëruar dhejtra shembuj të rrënimeve të pashembullta, që i bëri dora vehabite ndër të cilët: ndërtimi i deponisë së benizinës, në vend të varrit të Emines, nënës së Muhammedit a.s. në Ebva, vendosja e tregut të kafshëve në vend të shtëpisë së Hatixhes r.a. dhe ndërtimi i nevojtores (WC) publike në vend të shtëpisë së Pejgamberit a.s.

Shpresoj, që ky punim i imi sado pak të ketë hedhur dritë mbi çështjen e trajtuar, nuk gjej fjalë më adekuate se fjala e All-llahut për ta përmbyllur këtë trajtesë të shkurtër mbi lëvizjen vehabite. Lartmadhëria e tij thotë:

“Kush i kundërvihet Pejgamberit pasi që i është shpjeguar muga e vërtetë dhe e njëjës muga që nuk është muga e bashkësisë do ta lënë të veprjë ç’të dëshirojë e atëherë do ta hedhim në Xhehennem, e sa vend i shëntuar është ai.” (En-Nisa’, 115).

**Ensar Sinani III-A
Shkolla Qendrore**

¹ Shih: Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit Islam, Tetovë 2007, fq. 123-127

² Shih: Sejjid Ahmed ibn Zejn Dehlan (Mufti i Mekkes), Fitneja Vehabite, në kuadër të E vërteta rreth vehabizmit dhe vehabistëve, tre libra në një, Prizren – Tetovë 2002.

³ Shih: Grup autorësh, E vërteta rreth vehabizmit dhe vehabistëve, Prizren 2002

⁴ Titulli i librit, prej nga është marrë citati është: “Komploti kundër shtetit Islam”, Prizren-Tetovë 2002

⁵ *Tevessul* konsiderohet që dikush ta lexojë e drejtojë duanë All-llahut xh. sh. dhe në të ta përmendi Pejgamberin Muhammedin a. s. ose ndonjë pejgamber ose evlija tjetër me shpresë se All-llahu xh. sh. do t’i përgjigjet duasë së robit të tij për shkak të mëshirës dhe bereqetit të Tij ndaj robit të përmendur në dua.

Kjo mënyrë e duasë ka mbështetjen e vet në hadithet e Pejgamberit të All-llahut. Të parët që këtë dëshiruan ta largojnë nga mësimi Islam janë vehabijt.

⁶ Shih Sejjid Ahmed ibn Zejn Dehlan (Mufti i Mekkes), Fitneja Vehabite, Prizren-Tetovë 2002, fq. 4-6

⁷ Këto dy hadithe janë të marra nga revista “El-Ahnaf”, botuar në Zvicër, në vitin 2004. Hadithet e shënuara në revistë janë të përshtatur nga libri i çmueshëm “T’lau Sunen” i Imam Ahmed Dhafer Uthmani Et-Tehanevij.

⁸ Citat nga Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit Islam, Tetovë 2007, fq 150.

⁹ Shih: Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit Islam, Tetovë 2007, fq 149.

SHMI Medreseja Isa Beu – Shkup



СИУ „Иса Бег Медреса„ – Скопје



IHL "İsa Bey Medresesi" - Üsküp



4a



4b



GENERATA 22- 2005/2009

TAKIMI - 2019

СРЕДБА - 2019

GÖRÜŞME - 2019

DIGITAL FOTO BIDO

GENERATA XII E NXENËSEVE TË SHMI "MEDRESEJA ISA BEU" - SHKUP

**Bashkësia Fetare Islame në R.M
SH.M.I. Medreseja "Isa Beu"**
Paraleleja E Shtirirë E Medresesë-Tetovë
Gjenerata e dytë / 2005 -2009

IV-A TAKIMI 2019 IV-B

SAITI





**GJENERATA XXII E NXËNËSEVE TË SHMI
"MEDRESEJA ISA BEU" - SHKUP**

Emri dhe mbiemri	Fshati	Qyteti
1. Adnan Iseni	Nerasht	Tetovë
2. Berat Veseli	Xhepçisht	Tetovë
3. Bekim Bajrami	Gradec	Gostivar
4. Burhan Ramani	Saraj	Shkup
5. Bunjamin Ramani	Studeničan	Shkup
6. Emin Emiri	Koponicë	Shkup
7. Faton Miftari	Jagollë	Kërçovë
8. Ferat Ismaili	Silupçan	Kumanovë
9. Furkan Ademi	Vrapçisht	Gostivar
10. Hazir Jashari	Studeničan	Shkup
11. Ibrahim Azbiu	Debresh	Gostivar
12. Ismail Bajrami	Gradec	Gostivar
13. Jasin Mixhiti	Vranjofcë	Gostivar
14. Mujdin Xhaferi	Çajlë	Gostivar
15. Nejat Mena	Oktisi	Ohër
16. Rejhan Memedovski	Lisičan	Kërçovë
17. Sadan Dautovski	Lisičan	Kërçovë
18. Senad Sulejmani	Gradec	Gostivar
19. Vedat Luma	Gllaboçicë	Kosovë
20. Abdulhaki Musliu	Çajlë	Gostivar
21. Ali Aziri	Gërçec	Shkup
22. Amir Alili	Çegran	Gostivar
23. Arton Dauti	Çajlanë	Shkup
24. Allnes Zejnullai	Urviç	Tetovë
25. Erdoan Kamberi	Dobërdoll	Gostivar
26. Enes Halili	Odër	Tetovë
27. Elfat Loki	-	Tetovë
28. Fejsal Kamberi	Bajnicë	Gostivar
29. Ismail Xhabiri	Çajlë	Gostivar
30. Ismet Bajramovski	-	Kërçovë
31. Kujtim Mamuti	Hasanbeg	Shkup
32. Kujtim Miftari	Çegran	Gostivar
33. Kebir Bilali	Trebishtë	Gostivar
34. Pajtim Iseni	Rogle	Tetovë
35. Tarik Çolloviç	Batincë	Shkup
36. Mumin Vejseli	Negotinë	Gostivar
37. Rasim Ademi	Vërtëkicë	Shkup
38. Zumer Shabani	Forinë	Gostivar
39. Abdulbesir Neziri	Saraj	Shkup



**GJENERATA E DYTË E NXËNËSEVE TË
SHMI "MEDRESEJA ISA BEU" PARALELJA
E SHTRIRË E FEMRAVE – TETOVË**

Emri dhe mbiemri	Fshati	Qyteti
1 Fatime Abazi	Sllatinë	Tetovë
2 Mevlje Alidi	Gradec	Gostivar
3 Vebije Alili	Reçicë	Tetovë
	e madhe	
4 Nevrije Baki	Saraqinë	Tetovë
5 Bukurije Dehari	Reçicë	Tetovë
	e madhe	
6 Nazire Hakiki	Çellopek	Tetovë
7 Nurdan Huseini	Vrapçisht	Gostivar
8 Muhabije Imeri	Tetovë	Tetovë
9 Jasine Islami	Vrapçisht	Gostivar
10 Besjana Jakupi	Tetovë	Tetovë
11 Kujtime Mamuti	Çellopek	Tetovë
12 Pajtime Miftari	Tetovë	Tetovë
13 Hatixhe Mustafi	Dobrosht	Tetovë
14 Shpresa Nesimi	Pallçisht	Tetovë
15 Jumrije Ramadani	Tetovë	Tetovë
16 Jasmine Rustemi	Tetovë	Tetovë
17 Yejnepe Rustemi	Sellarcë	Tetovë
18 Amine Sulejmani	Gradec	Gostivar
19 Besa Abdullahu	Përshevcë	Tetovë
20 Sevime Abdul	Çegran	Gostivar
21 Lindita Alimi	Përshevcë	Tetovë
22 Fatjona Çela	Dibër	Dibër
23 Lumturije Ismaili	Tetovë	Tetovë
24 Elmedina Iseini	Çegran	Gostivar
25 Lebibë Jahija	Çellopek	Tetovë
26 Sheride Lika	Strazhë	Kaçanik-Kosovë
27 Merië Leka	Gllaboçicë	Kaçanik-Kosovë
28 Vjollca Ieka	Gllaboçicë	Kaçanik-Kosovë
29 Ganimete Ramadani	Tetovë	Tetovë
30 Haxhere Rizvani	Reçicë	Tetovë
	e madhe	
31 Sadet Rizvani	Reçicë	Tetovë
	e madhe	
32 Hasmije saliu	Çegran	Gostivar
33 Kadrije Sejdini	Çegran	Gostivar
34 Alije Hodai	Tetovë	Tetovë
35 Igballe Elmazi	Tenovë	Tetovë



**IHL "ISA BEY MEDRESESI"
I'Ci Nesil Öğrencileri**

1.Ercan Zekir	İştîp
2.Mumin Omerov	Alikoç-Radoviş
3.Seykan Osmanov	Vasilevo Ustrumca
4.Ramadan Memedov	Kılavuzlu-Radoviş
5.Engin Memedov	Kılavuzlu-Radoviş
6.Elvis Demirov	Vasilevo Ustrumca
7.Bayram İbrahimov	Bansko-Ustrumca
8.Ayati İbrahimov	Bansko Ustrumca
9.Şevki Sülman	Ocalı-İştîp
10.Şener Sülman	Buçim-Radoviş
11.Mümin Aliov	Pırnarlı-Radoviş
12.Ekrem Destanov	Yüksek Mahalle-Strumica
13.İbrahim Musliovski	Svetova-Üsküp
14.Şaip Dailovski	Luboş-Üsküp
15. Emin Memet	Radnya-İştîp





PSE NAMAZET KANË KËTO KOHË???

Pse Allahu pesë namazeve u ka përcaktuar pikërisht këto orare që ua dimë?

Aliu r.a. ka treguar se, në ndërkohë sa i dërguari po rrinte mes ensarëve e muhaxhirëve, i erdhi një grup hebrejsh e i thanë: "O Muhamed, ne po të pyesim për disa fjalë (dituri) që Allahu ia ka pas dhënë Musait, e që nuk ia jep tjetërkujt pa qenë i dërguar ose mbret i devotshëm." I dërguari a.s. u tha: "pyetni!" Ata thanë: "Na informo lidhur me pesë kohët e namazit, që Allahu ia ka bërë farz ummetit tënd!" I dërguari u përgjigj kështu:

Namazi i sabahut: "Kur të lind dielli, lind mes brinjëve të shejtanit dhe në vend të Allahut, jobesimtarët i bijnë në sexhde diellit. Ata i thanë: "Mirë e ke o Muhamed". -

- "S'ka besimtar që fal me xhemat për dyzet ditë rresht sabahun e që Allahu të mos t'ia -siguroj dy shpëtime, shpëtimin prej zjarrit dhe shpëtimin prej dyftyresisë" - Shtoi Muhammedi a.s., e ata i thanë përsëri: "Mirë e ke o Muhamed".

Namazi i drekës: "Është koha kur ndizet flakë xhehenemi dhe s'ka besimtar që fal këtë namaz e që Allahu të mos e ruajë nga flakët e xhehenemit Ditën e Kiametit".

Namazi i ikindisë: "Është koha kur Ademi a.s. hëngri nga ajo pema e ndaluar dhe s'ka besimtar, që fal këtë namaz e që të mos mbetet i pa gjynahë si ditën që e ka lindur nëna" - pastaj citoi ajetin: **"Mbani kujdes ndaj namazeve dhe ndaj namazit të mesëm..."** (El-Bekare:128)

Namazi i akshamit: "Është koha kur Allahu ia pranoi pendimin Ademit a.s. dhe s'ka besimtar, që fal këtë namaz duke ia ditur vlerën dhe i kërkon diçka Allahut e që të mos ia japë."

Namazi i jacisë: "Varri ka errësirë edhe Ditën e Kiametit ka errësirë. S'ka besimtar që ecën në errësirën e natës për ta falur jacinë e që Allahu të mos ta ruajë nga zjarri e të mos i jap nur me të cilin ta kalojë siratin. Jacia është namazi që e kanë falur të dërguarit para meje."

Fesal Fetai III-B
Shkolla Qendrore



PENDIMI PREJ VEPRAVE TË KËQIJA-TEUBEJA

Gjatë jetës së tij, njeriu shpeshherë mund të gabojë. Kështu nuk mund të gjesësh asnjë njeri që nuk gabon. Pas bërjes së gabimit, muslimani duhet pa u vonuar, të kthehet te All-llahu xh.sh. dhe ta lusë Atë për falje, në veçanti kur gabimi është i madh.

Ai person i cili bën vepra të këqija dhe i cili nuk pendohet, do të dënohet në ahiret. Pra, teube (pendimi) është kërkim i faljes për gabimin e bërë. Disa gabime të rënda nuk falen. Nëse personi që i vepron ato gabime nuk pendohet dhe nuk heq dorë prej tyre, do të jetë përgjithmonë në Xhehennem.

Pendimi duhet të realizohet me sinqeritet të plotë. Falja e gabimit kërkon plotësimin e këtyre kushteve:

- të pendohet për veprimin që e ka bërë;
- të heq dorë nga ajo vepër dhe
- të jep besën se nuk do të kthehet përsëri në atë vepër.

Nëse gabimi ka të bëjë me ndonjë person atëherë duhet të kërkoj falje prej tij ose duhet t'i kthehet haku atij.

Dyert e pendimit janë gjithnjë të hapura. Njeriu duhet dhe mund të pendohet gjatë tërë jetës deri në vdekje. Ekzistojnë shumë

forma dhe mënyra për t'u penduar, si psh: falja e namazit, agjërimi, haxhxi, lutjet e ndryshme etj. Prej lutjeve që më së shumti duhet ta përdorim është: "Kërkoj falje nga All-llahu dhe tek Ai kthehem".

Nëse besimtari është i sinqertë në pendimin e tij, All-llahu xh.sh jo vetëm që do t'ia falë atë, por ai ka premtuar se gabimet e tyre do t'i shndërrojë në sevape.

Muslimani duhet të shpejtojë në pendim, sepse ai nuk e di se sa do të jetojë!!!

"Kërkoj falje nga All-llahu i Madhërishtëm dhe Atij i kthehem!!!"

Muhamed Ramadani II-A
Shkolla Qendrore

DREJTËSIA DHE OBLIGIMET

Për çdo fajle namaz
Përherë merr abdes
Pastro trup e shpirt
Se s'ë din kur vdes.

Çelësat e Parajsës janë
Drejtësia dhe obligimet
Për epshet e shfrenuara
Do të vuhën dënimet.
Ata që e duan ryshfetin
I bëjnë dëm njerëzisë
Harrojnë Drejtësinë e obligimet
Dhe dënimet e Perëndisë.
Ditën e Gjykimit
I shoqëron djalli e mëkatet
Engjujt do të dëshmojnë
Cdo vepër në peshore matet.
Prandaj lexoni Kur'anin
Zbatoni rregullat e Drejtësinë
Të jeni të devotshëm
Të besoni Perëndinë.

*Xhineta Ademi viti I
Paralelja e Femrave - Gostivar*



GJURMËT NUK TRETEN...

Që kur di e mbaj mend
Gjithmonë rrinim bashkë,
Por, ja, sonte ti po shkon
E situata, këtë ma ndalon.

Përpiqem t'i radhis vargjet,
Por nuk arrij dot
Nuk rimojnë dot rrokjet,
Zemra zhytet n' lotë.

Syri im lot nuk nxjerr,
Se burrat nuk qajnë,
S' më vjen keq që jam vetëm,
Por, se ti po shkon larg.

Shumë vite të tëra,
Do të ikin, kalojnë,
Por unë fytyrën tënde,
Pranë, më s'do ta shoh.

Në letrën pa shenjë,
Në vijat e zbrazura,
Shpalos emocionet
Mbi ndarjet e hidhura.

Ti tretesh ngadalë,
Unë shkruaj këtë varg,
Veten mezi e mbaj
Për ty dua të qaj.

Edhe poezia s'del e bukur
Sikur e ndjen se s'jam i lumtur
Pikëllohem shumë e më shumë
Sa të dua ty, e di vetëm unë.

Edhe kur të kesh humbur

Gjurmët do lësh pas,
Se ato nuk treten,
Pas vdekjes jetojnë gjatë.

Ngjyra më tepron
Por nuk kam më letër,
Nuk jam tash në gjendje
Që të marr një tjetër...

E.S.



KUR HARROHET FEJA

Kur harrohet feja
Harrohet dhe njerëzia
Shkreptin si rrufeja
E zeza, ligësia.

Kur harrohet feja
Mbulon errësira
as këndeje, as andej
s'gjendet mirësia.

Kur harrohet feja
Harrohet dhe morali
Ndër të rinj e t' reja
Shpërthen amorali.

Nga e keqja s'turpërohet
I dobëti shfrytëzohet
Babë e nënë përçmohen
Fëmijët s'edukohen.

Kur harrohet feja
Mos pyet për çudinë,
Kur në sytë e tu
Sheh mizorinë.

Krenohet veç i marri
Diku shkrep zjarri,
Vdiset nga uria,
Vritet dhe fëmija
Pleqtë edhe gratë
Veç për një dhuratë,
Veç pse është njeri
Dhe kërkon liri,
Çlirimtari terrorist
E pushtuesi modernist...

Kur harrohet feja
Jeta s'ka kuptim
Çdo çast na shpjer
Në humbje e zhgënjim.

Vlora Limani viti I
Paralelja e Femrave –
Gostivar

KUSH NA KA KRIJUAR?

O vëllezërit e mi
Ndaluni e mendoni
Botën, që ju rrethon
Ndaluni e shikoni!

Yjet në hapësirë,
Që pa ndalë notojnë,
Tokën, diellin e hënën
Që rrugën s'e gabojnë!

Shikoni me kujdes
Fusha, male, kodra,
Dikush i ka krijuar
Ato nuk janë lodra!

Pra, o vëllezërit e mi
Mos mbeteni të hutuar
Dijeni të vërtetën
All-llahu na ka krijuar!!!

Besir Limani III-B
Shkolla Qendrore

O MUHAMMED

U gëzua mbarë njerëzia
ndërroi pamjen tërë gjithësia
ah,sa bukur shkëlqente Dielli
atë ditë që lindi Muhammedi.

All-llahu të zgjodhi ty
Pejgamber të dërgoi
me shumë emra të bukur
njerëzia të cilësoi.

Besnik i sinqertë,i moralshëm
të gjithë kështu të njihnin,
Zemra u qetësohej
kur me ty ata flisnin.

Ti je thesari i jetesës
Ti je lumë i gjithë shpresës,
Ti je shembull për njerëzinë
Ti je dritë për gjithësinë.

Ah sikur të t' kisha parë
asgjë në botë nuk do të doja
me ty të kisha biseduar
besimin tim ta forcoja.

Për ty lapsi ndërpritet
të flet për ty muslimani nuk mërzhitet
të respektojmë edhe pse s'të shohim
cilësitë e tua bukur i njohim.

Teuta Limani
Paralelja e Femrave - Gostivar



NUK JAM E SHTYPUR!

Më shikoni mua dhe më quani për të shtypur, vetëm për mënyrën se si jam e veshur, por ju nuk mund ta dini se ç'ka në mua, trupi im nuk është epiqendër e shikimeve tuaja, unë e mbroj feminitetin tim nga sytë tuaj qëllimkeq. Ju duhet t'i drejtoheni mendjes sime, se edhe unë jam njeri por nuk jam rob i burrave. Jeta, puna e vepra që e kryej i dedikohen vetëm All-llahut xh.sh. Unë do ta ngris zërin tim dhe do të bëj të dëgjohet ajo që e ndjej në zemrën time, unë mbahem vetëm për fjalën e Krijuesit tim.

O ju gra!!! Visheni trupin tuaj si i ka hije një muslimaneje të ndershme nëse doni të jeni të lira nga bezdisja e injorantëve. S'ka njeri që mund të më thotë të vishem në mënyrën tuaj, se unë jam kapur për fjalën e All-llahut xh.sh. dhe me të vërtetë nuk jam e shtypur. Jam e lirë, mua më është dhuruar liria shekuj më parë, më është dhënë e drejta për t'u rritur e për të prosperuar. Lirinë ma dha Zoti kur dërgoi Islamin mëshirë për të gjithë njerëzinë.

I dashur vëlla, e dashur motër,



ne nuk dimë të përgjigjemi sepse kemi harruar si pyetet. Nuk po e shohim të vërtetën si qielli mbi dete, sepse shikojmë duke menduar se sytë mund të shohin shumë, por s'e shohim veten. Ndoshta edhe peshku do të vdiste sikur të ngopej me ujë ,e uji lag gjithçka përpos vetes...

Kam qeshur pa e kuptuar pse erdha në këtë botë duke qarë, kam qarë pa e kuptuar pse kam

qeshur symbyllur ne djep. E dua dhembjen që më zgjoi nga gjumi i jetës, i asaj jete, që nuk do të doja të jetë e imja, sepse kafazi sa do i madh të jetë, përsëri kafaz është...

Të mahnitur se i dallojmë ngjyrat, ne harrojmë të mendojmë për dritën që na mundësoi dallimin e tyre.

Në rrugën e pishtarit ka dritë për të gjithë ata që nuk i mbyllën sytë para saj. Dritës nuk i duhet askush të dëshmojë se ajo ekziston, sepse ajo dëshmon vet për vetveten, prandaj ka kohë që s' dijmë të përgjigjemi, ngase kemi harruar se çdo pyetje ka përgjigjen e vet...

Trupi krijohet nga dheu dhe jeton në atdhe, ndërsa shpirti krijohet nga era dhe jeton në mërgim, pra lejoni mërgimtarët të kthehen në atdhe.

Nëse ke humbur shpresën, s'mund ta gjesh buzëqeshjen, luftoje atë që ta humb shpresën! Mundësia të ofrohet ty dhe të gjithëve, ngadhënjimi është i hapur, dera e tij është e hapur për ty dhe për të tjerët. Mësoje veten të jesh e hapur dhe shpresëdhënëse për veten dhe të tjerët. Përfytyro dobinë dhe të mirën për të gjithë..."Mos u trishto!!!"

Për njeriun fisnik poetët thurën:

"Sikur s'ju lejohet të thoni ndonjëherë jo,
çdo herë të nevojshmit i jep
i thua ç'dëshiron, kërko!
Në dimrin e ftohtë ti mbështetesh si diell,
e në verën e nxehtë qëndron..."

Hafsa Xhemaili
Studente



SHKRONJAT TË THËRASIN MOTËR!!!

Sa jemi të vetëdijshëm për gjërat që ndodhin, sa mendojmë, sa punojmë, sa mëngjese zbardhin e sa netë kalojnë, sa fleta rrëzon kalendari, e ne vazhdojmë të udhëtojmë, sa jemi të drejtë me veten, vallë a mendojmë? Vallë sa i shfrytëzojmë dhuntitë që na fali All-llahu xh.sh.???

Të drejtohem ty, oj motër, i drejtohem vetes, u drejtohem të gjithë atyre që gjenden nën flamurin "La ilahe il-lallah Muhammedun Resulull-llah. Pse, oj motër, lejon të të kaplojë errësira, kur drita të është dhënë, pse, oj motër, i afroresh greminës së injorancës, kur një dorë për të të shpëtuar para 1400 vjetësh të është zgjatur, atëherë kur zjarri i injorancës u shua, e shpella Hira ushtonte nga fjala "IKRE, IKRE"- "LEXO, LEXO", në emër të Zotit, që krijoi njerun pa asnjë mangësi??? Çfarë mesazhi ke marrë nga këto katër shkronja? Katër shkronja, por brenda çdo shkronje ka më tepër se aq.

Feja të urdhëron të jeshë në kërkim permanent të diturisë, e ti vazhdon me injorancë, feja të ka ngritur, e ti mendon se Evropa ka përparuar e po të dhuron një grimcë nga "kultura

dhe civilizimi i saj". Ti këtë mesazh e ke marrë para 1400 vjetësh, atëherë kur nga krijesa më e dashur e All-llahut xh.sh. nga krijesa më e bukur, filloi të ndriçojë drita e diturisë. Nga ai, i cili u sakrifikua, që të arrijë kjo dritë edhe deri te ti sot. E quajten të çmendur, e quajten magjistar, e persekutuan e çfarë nuk i bënë, të gjitha i duroi pa lëshuar asnjë ofshamë të vetme, vetëm për ne, për ty, ndërsa ti e nëpërkëmb këtë sakrificë...A e din, oj motër, se cila është arma jote e arma ime, cila është fuqia jonë? - Është lapsi, libri dhe feja jonë.

Thonë se Ebu Xhehli ka vdekur moti, por hija e tij ende edhe sot po jeton, ai na bën indiferent ndaj faktit se vëllezërit dhe motrat tona të Palestinës duan të na i fshijnë nga faqja e dheut... Ku jemi ne, oj motër, ku është zëri ynë? Deri ku kemi arritur, në çfarë pozite kemi sjellë veten, ku është fuqia jonë?

Hija e tij e rëndë, mbuloi horizontin edhe atje në Perëndim, ku në shenjë talljeje dhe përbuzjeje u karikaturua Muhammedi a.s. e ne prap heshtëm... trupin ma kaplojnë dridhjet dhe si e tërbuar pyes, po

ku janë lapsat tonë??? A ende nuk e sheh rrezikun, a ende nuk u binde se ku qëndron fuqia? Pse hesht? Pse nuk ndryshon? - Mos thuaj se është vonë..shkund pluhurin e injorancës, me këtë e mund armikun!!! All-llahu xh.sh. ka thënë: "Nuk e ndryshoj gjendjen e një populli deri sa ai nuk e ndryshon veten."

Pra, ja, fillo që tani... hape zemrën, që rrezet e diturisë të depërtojnë edhe në pusin më të thellë... Fillo, që tani... fillo se All-llahu xh.sh. të ka premtuar duke thënë: "Fe e vetme e pranuar tek All-llahu është Islami". Mos harro, falendero, që je pjestare e kësaj rruge dhe dije se pa dyshim...kënd e udhëzon All-llahu xh.sh. nuk ka kush që e humb, e kënd e humb Ai, s'ka kush që e udhëzon! Vazhdo e puno duke ditur se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Sikur të matej gjaku i shehidëve me dijen e dijetarëve, pa dyshim se dija e dijetarëve do të peshonte më shumë".

"Çdo bir i Ademit është gabimtar, por më i miri prej tyre është ai, që pendohet."

Nuraj Sherifi viti II
Paralelja e Femrave - Shkup



FEMRA PARA DHE PAS ARDHJES SË ISLAMIT

Historia na bën të dijmë dhe të shohim se popujt e hershëm, para shpalljes së Kur'anit, vërtetë kishin humbur rrugën e duhur dhe se shumica ishin larguar nga çdo gjë që ishte njerëzore, çdo gjë që ishte morale dhe edukative.

All-llahu xh.sh. e dalloi njeriun nga të gjitha krijesat, e krijoi prej dheu dhe ia dha formën më të bukur, por ajo që e ngrit njeriun mbi çdo krijesë tjetër nuk është forma e tij, ajo që e bën njeriun qenie më të vlefshme në tokë, që e bën atë mëkëmbës të All-llahut xh.sh. është aftësia për të kuptuar vlerat morale. Kësaj krijese të përsosur i është bërë obligim njohja e Krijuesit Absolut, që koordinoi me përpikshmëri lëvizjet e trupave në gjithësi, Atij të cilit vuri gjithçka në shërbim të njeriut dhe tokën ia bëri vendbanim ku do të jetoj dhe do ta adhurojë Atë.

All-llahu xh.sh. e krijoi njeriun në dy gjini të barabarta në të drejta, por shumica e njerëzve, siç ishin mushkrikët mekas në kohën e injorancës, të cilët të zhytur në injorancën që kishte kapluar mbarë botën, mendonin se fuqia është cilësi vetëm e mashkullit dhe se atij i takon sundimi mbi gjininë femërore. Kështu femra nënçmohej, në sytë e tyre ajo paraqiste shkakun e së keqes dhe vështirësive, prandaj sa herë që u lindte vajzë, u zbeheshin fytyrat nga mllefi dhe urrejtja për këtë qenie të pafajshme. Traditat dhe zakonet e tyre prapanike kërkonin varrosjen e gjallë të foshnjave femra, sikur ato nuk



meritojnë të marrin frymë dhe të jetojnë në këtë botë. Babai me duart e veta varros vajzën e tij të gjallë vetëm për hir të traditës...në çfarë injorance të thellë ishin këta njerëz zemërhekur!!!

Në atë shoqëri pagane femra nuk quhej njeri, ajo konsiderohej një plaçkë e thjeshtë, objekt dëfrimi për mashkullin.

Dhe në kohën kur femra po përjetonte, ndoshta epokën më të errët të ekzistimit të saj, po nga ajo shoqëri e degjeneruar shfaqet një mësim i ri, të cilin e predikonte Muhammedi a.s. të quajtur Islam, i cili proklamonte barazinë gjinore mes njerëzve, ashtu siç i ka krijuar vetë All-llahu xh.sh. të barabartë.

Ky mësim i ri, drita e të cilit shpejt do të kaplojë Gadishullin Arabik, për t'u shtrirë më pas edhe në Afrikë dhe Evropë, ia njohu femrës të drejtat e saja, e nxori nga errësira e injorancës dhe padrejtësisë në dritën e dijes, barabarësisë dhe drejtësisë. Ndaloj varrosjen e saj të gjallë dhe jo vetëm kaq, urdhëroi që për çdo foshnje të lindur femër të theret një kurban, në shenjë falënderimi ndaj All-llahut xh.sh. Islami femrës, i dhuroi mëshirë kur është nënë, mirësjellje ndaj saj kur është vajzë, ia njohu të drejtën e zgjedhjes dhe vendosjes në martesë, të drejtën në trashëgimi dhe shumë të drejta të tjera që rezultojnë me ngritjen e pozitës së saj në shoqëri.

**Xhejlane Mustafa viti III
Paralelja e Femrave -
Shkup**



DURIMI I NJË NËNË



Njëri nga sahabët një herë e kishte thirrur Resulull-llahun për në drekë. Theri një deve dhe pastaj shkoi për të mbledhur drunj për ta pjekur devenë .

Ai kishte dy djem. Njëri shkonte të marrë mësim nga sahabet e shquar, ndërsa tjetri qëndronte tërë ditën në shtëpi, sepse ishte i vogël. Atë ditë djali i madh sapo u kthye në shtëpi, i tha të vëllait:

- Më trego si e theri babi devenë!

- Ti shtrihu në tokë dhe unë do të tregojë si e theri devenë! - ia ktheu i vogli.

Djali i madh u shtri në tokë dhe i vëllai ia lidhi duart e këmbët ashtu siç kishte parë babanë të bënte me devenë. Pasi e lidhi, mori thikën e tha: "Bismil-lah! All-llahu Ekber" dhe ia preu kokën.

Nëna që pa këtë deshi ta rrihte, ndërsa djali nga frika hipi ne çatinë e shtëpisë. Pastaj nga

frika ra që aty dhe vdiq edhe ai. Nëna e tyre mendoi: "Edhe një herë që po vjen Resulall-llahu në shtëpinë tonë, nuk bën që ta mërzhisim me një ngjarje të këtillë", prandaj i mori dhe i fshehu kufomat e të dy djemve. As burrit të saj, që u kthye në shtëpi me drunj të nuk i tregoi gjë.

Ndezën zjarrin dhe e poqën devenë . Kur erdhi në shtëpi Resulull-llahu u ul në sofër dhe i pyeti: "Ti ke dy fëmijë, ku janë ata? Thirri të vijnë dhe të ulen në sofër!"

Buri i kërkoi gruas që ti thërriste fëmijët, por ajo i tha: "Ata nuk vinë dot tani, unë po e veçoj pjesën e tyre ". Babai u kthye te Resulull-llahu dhe i tha: "Ne e kemi veçuar ushqimin e tyre prandaj ju hani rehat!" Resulull-llahu tha: "Unë nuk ha po nuk erdhën edhe fëmijët." Babai i fëmijëve u fut përsëri brenda, për të kërkuar

fëmijët, por këtë herë gruaja i tregoi se çfarë kishte ndodhur, se nuk ia fshihte dot më burrit të saj. Babai u kthye te Resulull-llahu i pikëlluar edhe i tregoi se çfarë kishte ndodhur. Në atë moment erdhi Xhibrili a.s dhe i tha Resulull-llahut: "O Resulull-llahu, All-llahu të dërgon selam dhe tha: "Pejgamberi im i dashur të mos mërzhitet, të bëjë dua që fëmijët të ringjallen edhe sahabët të thonë amin, që Unë t'i ringjall fëmijët! Nëna e tyre bëri durim të mos e mërzhiste Pejgamberin Tim. Në saje të durimit të saj dhe për respektin tënd Unë i ringjall ata."

Resulull-llahu bëri dua dhe sahabët thanë amin pas tij. Fëmijët u ringjallën sikur të zgjoheshin nga gjumi, pastaj u ulën së bashku dhe drekuan të gëzuar...

**Besar Saliu II-A
Shkolla Qendrore**



E FOLURA E FOSHNJES

Në kohën e Hazreti Muhammedit a.s jetonte një grua e cila nuk e donte Resulull-llahun dhe nuk linte fjalë të keqe pa thënë për Të.

Një ditë gruaja kishte dalë së bashku me djalin e saj 2-3 muajsh. Gjatë rrugës pa Resulull-llahun dhe mendoi ta shante. Por përpara se të fillonte të fliste ajo, filloi të flasë foshnja në djep: "Selam për ty o i Dërguari i All-llahut, o Muhammed i biri i Abdull-llahut!". Gruaja ngriu në vend nga çudia. Resulull-llahu iu drejtua foshnjës duke buzëqeshur dhe i tha: "Nga e di që unë jam i Dërguari i All-llahut? Kush ta ka mësuar ty emrin tim dhe emrin e babait

tim?" -

-Fëmija tha: "Mua këto m'i ka mësuar Krijuesi i botës All-llahu. Ai All-llah, që krijon çfarë të dëshirojë". Foshnja pushoi pak dhe pastaj filloi të fliste përsëri:

"O i Dërguari i All-llahut bëj dua për mua që të bëhem unë shërbyesi yt në Xhennet!". Pejgamberi bëri dua për foshnjën, ndërsa foshnja që mbeti i kënaqur nga kjo filloi të flasë rishtas: "Sa fatlum është ai që të beson ty dhe bëhet besimtar, dhe sa fatkeq është ai, që nuk te beson ty e bëhet mohues! All-llah, poshtëroi ata edhe në këtë botë edhe në ahiret!" Pasi tha këto fjalë foshnja ra në shehadet

dhe dha shpirt.

Gruaja që zuri mend nga ngjarja e çuditshme që pa, u bë me njëherë muslimane dhe duke qarë tha: "Më fal o Resulall-llah! Jam shumë e pikëlluar për jetën time, që e kam kaluar si mëkatare!" Resulull-llahu u kthye nga gruaja dhe tha këto fjalë: "Po të jap një lajm të mirë! Tani po shoh shumë engjuz që po sjellin qefinin tënd nga Xhenneti". Gruaja sapo dëgjoi këto fjalë menjëherë dha shpirt duke rënë në shehadet, ashtu si foshnja e saj.

Hasnije Saliu IV-B
Paralelja e Ferrave - Tetovë

JETIMI ËSHTË I NDERUAR TEK ALL-LLAHU

Allahu .xh.sh.në një hadhith kudsit thotë: "Kush mundohet ta bëjë të kënaqur dhe ta qetësojë një jetim që është duke qarë, unë dëshmoj, o melekët e mi se do të jem jetimi i kënaqur me atë person.

Kush e përkëdhel kokën e jetimit, për çdo fije floku ka nga një të mirë. Shtëpi më e mirë është ajo shtëpi, në të cilën nderohet jetimi, kurse shtëpi më e keqe është ajo në të cilën përbuzet ai. Atij që përkujdeset për jetimin i mjafton kjo fjalë e Muhamedit a.s.: "Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në xhenet kështu." dhe bashkoi dy gishtat, treguesin dhe të mesmin.

Një jetimi babai i kishte lënë një lopë, që kur të rritet të ketë me çka të mbahet materialisht.

Kur u rrit, shkoi ta shiste atë, u konsultua me të ëmën dhe ajo ja përcakttoi një çmim. Gjatë rrugës e pa një njeri dhe i tha: "Unë do ta blej lopën me një çmim më të madh", por djaloshi i tha: "Prit sa të konsultohem me nënën". Kështu ndodhi tri herë, por secilën herë çmimi rritej. Më në fund ai njeri i thotë djaloshit: "Unë jam melek nga qielli, lopën shite vetëm atëherë, kur të të japin flori sa pesha e saj".

Pastaj ndodhi një ngjarje tjetër: një njeri dëshironte ta vrasë xhaxhanë e vet, që ta trashëgojë pasurinë e tij. Kur e vrau, për këtë, u akuzuan njerëz të tjerë të pafajshëm, të cilët për ta vërtetuar pafajsinë e tyre, Allahu xh.sh. i urdhëroi që ta therin një lopë me cilësitë e

caktuara nga Ai, e lopa të cilën e caktoi Zoti, ishte lopa e djaloshit. Kështu që ata erdhën te djaloshi e ai ua tregoi çmimin e lopës dhe ato ia dhanë, i dhanë flori sa pesha e lopës. E therën lopën dhe vepruan siç i kishte urdhëruar Zoti, pra morën një copë mish dhe e prekën me të të vdekurin. I vdekuri u çua, tregoi vrasësin dhe vdiq përsëri. Ndërsa jetimit All-llahu xh.sh ia mundësoi, që ta shesë lopën për shumë tepër të madhe florinjsh me çka i siguroi të ardhurat e nevojshme për mirëmbajtjen e familjës së tij. Ky shembull vërteton se jetimi është i nderuar tek All-llahu, i Cili në njëherë apo tjetrën mënyrë nuk e lë atë të vuaj asnjëherë....

Habib Ebibi I-A
Shkolla Qendrore

SI TË SILLEMI NDAJ TË AFËRMVE, JETIMËVE, TË VARFËRVE DHE UDHËTARËVE

Islami kujdeset për të gjithë njerëzit. Njëherit ata i mëson se të gjithë njerëzit janë të barabartë pa dallim race, ngjyre, besimi, ideologjie, përkatësie kombëtare etj. janë krijesa të All-llahu xh. sh. dhe ndaj tyre duhet të sillemi si vëllau ndaj vëllaut.

“O ju njerëz! Pa dyshim ne u krijuam prej një mashkulli dhe prej në ferre (Aderit dhe Havës), ju keni ndarë në korbe e fise në mes veti që të njiheni. Me të vërtetë në fisnik prej jush është ai i dli i frikështet All-llahu xh. sh. në së tepëmi. Vërtetë All-llahu xh. sh. din për çdo send dhe për të gjithë është i informuar.”

Sjellja e mirë duhet të jetë ndaj të gjithë njerëzve në përgjithësi, sepse çdo individ ka të drejtën e tij edhe atë të drejtë ia ka dhënë All-llahu xh. sh.

Që të të respektojnë të tjerët,

patjetër t'i respektosh; që të të ndihmojnë të tjetër, patjetër duhet që t'u ndihmosh; që mos të të cenohen të drejtat e tua, duhet që edhe ti të mos ia cenosh të drejtën tjetrit.

Transmeton Abdullah ibën Omeri r.a. se një njeri erdhi te Pejngamberi a.s. dhe e pyeti: O I Dërguari i All-llahu xh. sh.t, cili njeri është më i dashur te All-llahu xh. sh. dhe cilat janë veprat më të dashura te All-llahu xh. sh.?

Pejngamberi a.s. iu përgjigj: **“Njerëzit më të dashur te All-llahu xh. sh. janë më të dobishmit për njerëzit, kurse veprat më të dashura te All-llahu xh. sh. janë:**

- ai që e përmban hidhërimin e tij All-llahu xh. sh. ia mbulon të metat,
- ai që e ngulfat mllëfin e

tij edhe pse ka mundësi të hakmerret, All-llahu xh. sh. ia mbush zemrën me shpresë në Ditën e Kijametit,

- ai që ecën me vëllanë e tij derisa të ia kryej një nevojë që ka, All-llahu xh. sh. ia forcon këmbët atë ditë ku shumë këmbë rëshqasin.”

Ky është një prej haditheve të cilët nxisin dashurinë ndaj All-llahu xh. sh. dhe ndaj njerëzve, përhapë frymën vëllazërore mes muslimanëve dhe i forcon marrëdhëniet në mes besimtarëve.

Ky hadith na mëson vlerat e moralit, edukatën e muslimanit, sjelljen e mirë, virtytet e larta, udhëzime që ta pastrojnë shpirtin, përmirësojnë shoqërinë dhe sjellin lumturi te individët dhe shoqëria.

Ne si musliman kemi shumë





obligime që na ka porositur All-llahu xh. sh. edhe atë së pari kemi obligime ndaj vetes tonë, ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj fqinjëve, ndaj udhëtarëve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj të vjetërve, ndaj të dijshtëmëve etj.

All-llahu xh. sh. xh. sh. i ka dalluar njerëzit në poste dhe autoritet, në dije dhe adhurim, dhe ka caktuar që njerëzit të jenë në shërbim të njëri-tjetrit për t'u zhvilluar mëkëmbësia dhe të zhvillohet jeta në rruzullin tokësor, All-llahu xh. sh. thotë: "Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë: Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime." (Ez - Zuhruf: 32).

SJELLJA NDAJ TË AFËRMVE

Islami na mëson që të mos jetojmë vetëm për vete, për fëmijët tonë dhe për prindërit, por njëkohësisht rekomandon që të kujdesemi edhe për farefisin.

All-llahu xh. sh. na rekomandon që t'i ruajmë dhe t'i kultivojmë marrëdhëniet fisnore. All-llahu xh. sh. thotë: "*Përkujtoni Kur ne morëm zotinin e bijve të israilit; mos adhuroni tjetërkë përveç All-llahu xh. sh., të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve u thuani fjalë të mira; Faleni namazin dhe jepni zeqatin, e pastaj ju e thyet zotinin dhe përveç një pakice prej jush, ia kthyet shpinën zotinit*" (El Bekare:83)

"E Pejgamberi është më i ndijshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetëvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre (të besimtarëve).

E ata (të afërmit) farefisi nga barku, sipas dispozitave të All-llahu xh. sh. kanë më tepër përparsi ndaj njëri tjetrit se sa besimtarët e tjerë dhe se sa

muhaxhirët përveç nëse dashamirëve tuaj dëshironi t'i bëni ndonjë të mirë.

Kujdesi ndaj farefisit ose ndaj të afërmeve mund të manifestohet në disa mënyra si:

- vizita e shpesht dhe pranimi në shtëpi,

- ndihma materiale nëse ka nevojë,

- ndihma morale në raste të dhembshme,

- peshqeshet - dhuratat në rastet e vizitave etj.

Muhammedi a.s. shpesh herë ua ka tërhequr vërejtjen pasardhësve të vet për obligimet dhe detyrat ndaj farefisit duke iu drejtuar për mëkatet e mëdha të atij që i lë pas dore këto detyra.

Ebu Remime thotë se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. kur i ka thënë një as'habi: "**Kujdesuni për nënën dhe babanë, pastaj motrën dhe vëllanë tënd, e madje për të afërmit e tu, madje për kushërinjtë më të afërm**".

Ebu Hurejreja r.a. transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë: "**Ai që i beson All-llahut xh. sh. dhe Ditës së gjykimit, le t'i kushtojë kujdes të veçantë farefisit të vet dhe le t'i bëjë vetëm të mira; ai që i beson All-llahut xh. sh. dhe Ditës së gjykimit le të flet vetëm të vërtetën dhe atë që është e nevojshme, përndryshe le të heshtë**".

Ai që kujdeset për farefisin do të jetë fatlum edhe në këtë jetë. Jeta e lumtur dhe fatlume në këtë botë është e kushtëzuar nga shumë faktorë, por një prej tyre është edhe kujdesi ndaj farefisit.

Muhammedi a.s. thotë: "**Ai që dëshiron të jetojë shumë dhe të jetë i pasur le të dëgjojë prindërit e vet dhe le të kujdeset për farefisin e vet**".

Seid ibën Zejd transmeton se në një rast Muhammedi a.s. ka thënë: "**Në mëkatet më të**

mëdha llogariten: shkelja e nderit dhe dinjitetit të një muslimani. Nëse e harron farefisin e vet dhe i ndërpret marrëdhëniet me All-llahun xh. sh. i ndalohet hyrja në Xhennet."

Muhammedi a. s. nuk ka lejuar që të ndodhet në shoqërinë e tij ai që është në grindje me farefisin, edhe pse Muhammedi a.s. me kënaqësi dhe me fytyrë të çelë I pranonte të gjithë njerëzit në shoqërinë e vet, megjithatë nuk ka dashur ta shohë afër vetes njeriun i cili ka qenë në grindje me dikënd nga familja ose farefisi. Ja një rast ku prej të cilit shihet se Abdullah ibën Efva transmeton kështu: "**Një rast ishim tek Pejgamberi a.s. i cili tha: Sot mos të rijë me ne ai i cili është në grindje me dikënd nga farefisi i vet. Në një moment u çua një i ri dhe u largua nga shoqëria. Atëherë Muhammedi a.s. i tha: Nuk i takon mëshira e All-llahut xh. sh. atij që është në grindje me farefisin ose me ndonjë antarë të farefisit të vet.**" I riu shkoi te teza ja e vet i kërkoi falje për të gjitha fjalët dhe ofendimet që ia kishte bërë dhe u kthye te shoqëria.

"**Me të vërtetë All-llahu xh. sh. nuk i do ata që bëjnë turbullira**".

Këtu ka për qëllim për disa njerëz të cilët fusin turbullira në mes disa antarëve të afërmeve, ata All-llahu xh. sh. i këshillon se do të kenë një dënim të rreptë sepse ata bëjnë mëkate të mëdha dhe se All-llahu xh. sh. nuk i don dallaverexhinjtë.

Nga e gjithë kjo, që thamë shihet qartë se All-llahu xh. sh. dhe Pejgamberi a.s. i ka dhënë rëndësi të madhe lidhjeve farefisnore.

**Vjollca Leka IV-B
Paralelja e Femrave -
Tetovë**



XHAMIA E DY KIBLEVE

Një ndër xhamitë më të njohura në Medine dhe që ka vlerë të madhe historike, është edhe xhamia e dy kibleve, e cila gjendet në perëndim të Medinës, 3,5 km larg Xhamisë së Pejgamberit a.s. Në këtë vend në kohën e Muhammedit a.s. ka jetuar fisi Beni Seleme, fis arab. Është ndërtuar në kohën e Pejgamberit a.s. prej materialit të thjeshtë ,gurëve, drunjve të hurmave dhe fletëve të saj. Historianët pohojnë se Shahin El-Xhemali në vitin 893 H. e rindërtoi këtë xhami për herë të parë ndërsa në vitin 950 H. për herë të tretë e rindërtoi sulltan Sylejmani, në kohën e Pushtetit Osman .Rindërtimi i xhamisë nuk mbeti vetëm me kaq, Mbretëria Saudite i kushtoi rëndësi të madhe këtij objekti madhështor, i cili u rindërtua edhe dy herë të tjera, herën e parë në kohën e mbretit Halid, kurse herën e dytë në vitin 1988 mbreti Fahd, bëri rindërtimin modern të saj.

Pse kjo xhami e mori emrin xhamia e dy kibleve?

- Kible i thuhet anës, kah e cila drejtohen muslimanët gjatë faljes së namazit. Pas shpërnguljes së Muhamedit a.s. në Medine, më tepër se një vit e gjysmë u fal në drejtim të xhamisë së Aksasë - Kudsit, ndërsa Qabeja përveç, që ishte në duar të idhujtarëve, ishte e mbushur përplot idhuj. Pejgamberi a.s. kishte dëshirë të flaktë të kthehet kah Qabeja, këtë e vërteton edhe ajeti kur'anor ku thuhet: **“Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabes), që ti e do atë. Pra, kthehu anës së**

xhamisë së shenjtë (Qabes) dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah kjo anë...” Muhammedi a.s. përderisa ishte duke e falë drekën në këtë xhami, i drejtuar në drejtim të xhamisë së Kudsit, i erdhi shpallja nga Allahu xh.sh., për ndryshimin e drejtimin të kibles gjatë faljes. Ai reقاتin e parë dhe të dytë e fali në drejtim të Kudsit, e pasi i erdhi shpallja u kthye bashkë me xhematin në drejtim të Qabes dhe vazhduan faljen e dy reqateve të fundit. Kjo është arsyeja e emërtimit të kësaj xhamie me emrin: “Xhamia e dy kibleve”.

Pejgamberi a.s. dhe muslimanët u gëzuan pa masë kur u urdhëruan nga All-llahu, që të kthehen në drejtim të Qabes, ngase ky ishte edhe një paralajmërim, se ajo do të kalojë në duart e muslimanëve, siç edhe ngjau. Në anën tjetër, ndryshimi i kibles ishte edhe një sprovë, ku u dalluan të sinqertit nga të luhatshmit, e këtë, ja se si e ilustron Kur'ani: **“E kiblen nga e cila u drejtove nuk e bëmë për tjetër, vetëm se për të sprovuar atë që shkon pas Të Dërguarit, nga ai që kthehet prapa, ndonëse kjo ka qenë vështirësi për disa, por jo edhe për ata, të cilët Allahu i drejtoi.”** Ndryshimi i kibles shkaktoi polemikë edhe te ithtarët e librit, krishterët dhe hebrenjtë, sepse mendonin se vetëm kibleja kah e cila kthehen ata është e drejtë dhe talleshim me muslimanët, duke thënë se Islami bën lojë me kiblen, herë në anë të Kudsit - Jerusalemit të sotëm, e herë, në anë të Mekës. Për këtë arsye zbrit ajeti kur'anor nga All-llahu xh.sh. ku thotë: **“Nuk është tërë e mira**

(e kufizuar), të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librave, pejgamberëve dhe i cili pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë dhe të durueshmit në skamje ,në sëmundje dhe në flakën e luftës, të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit”

Jasir Osmani III- A
Shkolla Qendrore





PA ISLAM S'KE KURRFARË VLERE

Falënderimet i takojnë All-llahut. Ai është i falënderuar dhe i lartësuar në çdo situatë, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kënd e udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kënd e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç All-llahut, i vetëm dhe i pa shoq, si dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të, mbi familjen e tij të nderuar, mbi shokët e tij besnikë dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. Nga parimet dhe mësimet tona themelore është që të jemi krenarë, që jemi pjesëtarë të kësaj feje të pastër dhe të ndihemi të nderuar që All-llahu i Lartësuar na ka bërë muslimanë. Ai që nuk ndihet i nderuar me këtë fe dhe nuk është krenar që është musliman, në zemrën e tij ka dyshim dhe jobindshmëri. All-llahu i Lartësuar, duke iu drejtuar të Dërguarit të Vet, thotë: **“Dhe se ajo (shpallja) është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd dhe për këtë (lëvdatë) më vonë do të përgjigjeni.”** (Zuhruf: 44) Pra, është obligim dhe nder të krenohesh me Islam, se je pjesëtar i ummetit të Islamit, të krenohesh me Kur'an, se je pjesëtar i ummetit të Kur'anit.

Gjithashtu, All-llahu i Lartësuar thotë: **“E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartët, po qe se**

jeni besimtarë të sinqertë.” (Ali Imran: 139). Më të lartët në mbështetje, më të lartët në parime, më të lartët në metodologji. Parimet tona janë parime të bazuara në Kur'an, e Kur'ani ynë është Kur'an fisnik, mbështetësi ynë është All-llahu Fuqiptotë. Atëherë, si mund të dobësohet ai që ka All-llahun që e mbështet? Si mund të dobësohet kur All-llahu është Zoti dhe Strehuesi i tij? Si mund të dobësohet kur i Dërguari, paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të, është shembull për të? Si mund të dobësohet kur Islami është feja e tij? Pra duhet të jemi krenar dhe ballëhapur për këtë fe të nderhme të pastër dhe fisnike. Obligim i yni është të krenohemi dhe të ndihemi të ngritur e të lartësuar atë ditë që All-llahu na ka bërë pjesëtarë të Islamit. Prandaj, i tërë nderi nuk qëndron në pallate të larta dhe në pasuri, por nder dhe krenari është të jesh rob i All-llahut, Krijuesit të qiejve dhe të tokës. Nder është të jesh nga të afërmit e All-llahut të Lartësuar, të cilët janë vepërmirë dhe largohen nga të ndaluarat, i urdhërojnë të tjerët në të mirë dhe i ndalojnë nga e keqja, pra besimtari ia mbulon të metat vëllait të tij, ndërsa i brishti i zbulon dhe publikon ato.” Ka thënë Aliu, All-llahu e mëshiroftë: “Besimtarët janë këshillues, ndërsa hipokritët janë mashtrues.” Mos lejo të bëhesh nga mashtruesit, nga ata që pretendojnë se parimet e nderit, të lartësisë dhe të krenarisë janë në zotërimin e pasurisë dhe të mirave të kësaj bote. Për këtë lloj të njerëzve, All-llahu i lartësuar në Kur'an thotë **“Pastaj thanë:**





Përse të mos i ketë zbritur ky Kur'an një njeriu të madh nga dy qytete? A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberllëkun) e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar



